**(Për miratimin e Raportit Përfundimtar Sh.02.nr.31683 të datës 18.09.2023, i hartuar nga Komisioni Profesional Komunal Sh.02.nr.14580 i dates 25.04.2023 i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.nr.24967 i datës 28.07.2023, mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore gjegjësisht Breshëri në Pemishtën e znj.Valbona Pireva, dëmet e shkaktuara nga Breshëri që ka rënë me datën 23.07.2023, në fshatin Tugjec të Komunës së Kamenicës, në vlerë totale prej 9,934.65 Euro)**

1. Miratohet Propozim – Vendimi Sh.02.6699 i datës 29.02.2024 për Miratimin e Raportit Përfundimtar Sh.02.Nr.31683 , të datës 18.09.2023, hartuar nga Komisioni Profesional Komunal Sh.02.Nr14580, të datës 25.04.2023, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.02.Nr.24967, i dates 28.07.2023 mbi vlersimin e dëmeve të shkaktuara nga Breshëri i rënë i datës 23.07.2023, në fshatin Tugjec të Komunës së Kamenicës, në vlerë totale prej 9,934.65 Euro.

2. Me miratimin e këtij vendimi miratohet Raporti i Dëmeve i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, i shqyrtuar dhe miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, Raporti përmban një vlerësim profesional nga të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim të Komisioneve paraprake të emëruara nga Kryetari i Komunës dhe Kërkesës për kompensim të dëmeve nga znj.Valbona Pireva e dëmtuar nga Breshëri i cekur në pikën 1 (një) të këtij vendimi, , dhe i njëjti raport i miratuar nga Kuvendi i Komunës në afat ligjor prej 15 ditëve nga dita e miratimit i dorëzohet Agjencionit të Menaxhimit Emergjent, dhe një kopje të njëjtësuar Komisionit Qendrorë të Themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

3. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Kryetari i Komunes në bashkëpunim me Komisionin Profesional Komunal mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga Breshëri.

4. Bashkangjitur e gjeni Raportin pëfundimtar Sh.02.nr.31683 të datës 18.09.2023, si dhe shkresat tjera përcjellëse.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Qeverisje Lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Zyrës së Informimit;***
- ***Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim;***
- ***Komisionit Qendror Qeveritar;***
- ***MAPL-së; dhe***
- ***Arkivit.***

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 7331
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 05/03/2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 05.03.2024**

Në Bazë të nenit 12 dhe 40 paragrafi 40.1 të Ligit Nr.03/L-040 për Vetqevorisje Lokale, nenit 38 paragrafi 38.1 te Statutit Sh.01.Nr.20203 të dates 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës dhe nenit 12 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, Kuvendi i Komunes, në mbledhjen e mbajtur më 29.02.2024 miraton këtë:

## V E N D I M

### Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Bazë Sh.01.Nr.7976

1. **NDRYSHOHET** dhe **PLOTËSOHET** pika (1) një, nën paragrafi (1.7) një pikë shtatë, (1.8) një pikë tetë dhe (1.12) një pikë dymbëdhjetë i Vendimit bazë Sh.01.nr.7976 i datës 09.03.2023 për formimin e komisionit për organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore të Komunes së Kamenicës për vitin 2024-2026, me përbërjen si në vijim:

   **1.1**. Në paragrafin (1.7) një pikë shtatë në vend të anëtares së Komisionit znj. Valdete Berisha (ZK), caktohet anëtare e re e Komisionit znj.Lidiona Marovca.

   **1.2**. Në paragrafin (1.8) një pikë tetë në vend të anëtares së Komisionit znj.Florentina Kryeziu (DMSH), caktohet anëtar i ri i Komisionit z.Edon Dërmaku.

   **1.3**. Në paragrafin (1.12) një pikë dymbëdhjetë në vend të anetarit të Komisionit z.Bajrush Kriezi (ZLK), caktohet anëtare e re e Komisionit znj. Aleksandra Jovanovic (nënkryetare e Komunës për Komunitete).

2. Detyrat e anëtarëve të Komisionit si në pikën (1) një, paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij vendimi, janë të përshkruara në Vendimin bazë Sh.01.Nr.7976 i datës 09.03.2023 për Organizimin dhe Mbajtjen e degjimeve buxhetore të Komunës së Kamenicës për vitin 2024 - 2026.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Qeverisje Lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Zyrës së Informimit;***
- ***MAPL-së; dhe***
- ***Arkivi***

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS – OPŠTINA KAMENICA
01 KUVENDI I KOMUNËS – SKUPŠTINA OPŠTINE

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 7333
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 05/03 2024
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 05.03.2024**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për vetqeverisjen Lokale, nenit 9 paragrafi 1.7 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/12 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi si dhe Planit Sh.02,Nr.7257/05.03.2024 të Punës së KKSB-së për vitin 2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me date:29.02.2024 mori këtë:

## VENDIM

1. **Miratohet** Plani i Punës së Komisionit Komunal për Siguri në Bashkësi Sh.02,Nr.7257/05.03.2024, për vitin 2024,

2. Pjesë e këtij vendimi është Plani Komunal për Siguri në Bashkësi,Sh.02,Nr.7257/05.03.2024 .

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal,

**Vendimi ti dorëzohet:**
**1x1 MAPL-së**
**1x1 Zyrës së Kryetarit,**
**1x1 QSHQ-arkiv**

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E KAMENICËS – 01 KUVENDI I KOMUNËS – REPUBLIKA KOSOVA – OPSTINA KAMENICA – SKUPSTINA OPS.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 7335
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 05/03 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 05.03.2024**

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 40, nenit 51 paragrafi 51.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 13 dhe nenit 14 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, neni 38, 46 paragrafi 46.1 dhe paragrafi 46.3 të Statutit Sh.01.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.02.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
## Për Themelimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik Lokal

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës në Kamenicë themelon Komitetin për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe përcakton numrin e anëtarëve si në vijim:

2. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Lokal i përbërë nga 9 (nëntë anëtarë).

   **2.1** Rina Krasniqi, (anëtare e kuvendit)
   **2.2** Albana Ajvazi, (anëtare e kuvendit)
   **2.3** Valentina Kastrati, (anëtare e kuvendit)
   **2.4** Labinot Skoverqani, (anëtar i kuvendit)
   **2.5** Kadrije Mustafa, (Përfaqësuese e bizneseve)
   **2.6** Ibadete Sadiku, (Përfaqësuese e bizneseve)
   **2.7** Bastri Januzi, (Përfaqësues i bizneseve)
   **2.8** Fatmir Krasniqi, (Përfaqësues e bizneseve)
   **2.9** Lavdim Klaiqi, (Shoqëri Civile)

3. Shumica e anëtarëve të komitetit të themeluar sipas pikës 1 të këtij vendimi do të përbëhen nga anëtarët e kuvendit që duhet të reflektojë përbërjen e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit jashtë Kuvendit të Komunës që janë ekspert të fushave përkatëse.

4. Anëtarët e komiteteve tjera për punën e tyre kompensohen nga buxheti i Komunës, shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve të përhershme, anëtarët e komiteteve tjera paguhen për gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda viti.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Zhvillim Ekonomik Lokal janë të përcaktuara në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë.

6. Ky Vendim hyn në fuqi (15) ditë pas regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Qeverisje Lokale, si dhe (7) ditë pas publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës.

*Vendimi i`u dërgohet:*

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Zyrës së Informimit;***
- ***Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik;***
- ***MAPL-së;***
- ***Anëtarëve të Komitetit; dhe***
- ***Arkivit***

**Eliridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 7337
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 05/03 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 05.03.2024**

Bazuar në nenet 12 dhe 14 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenin 11 të për dhëniene në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Qarkorën Ligjore për procedurën e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim , sipas nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhëniene në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 23 i Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nxjerr nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 10.08.2020, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.02.2024 miratoi këtë:

**VENDIM**
**Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për " Hydeajet Pireva B.I " , me procedurë të negocimit të ofertës**

1. Me këtë vendim "Hydajet Pireva B.I" - (Certifikata e Regjistrimit: 812093615) , me përfaqësues Hydajet Pireva nga Kamenica, **i IPET** në shfrytëzim afatgjatë prej njëzetë (20) vitesh, prona e paluajtshme e Komunës, sipas procedurës së negocimit.

2. Prona e paluajtshme e Komunës e dhënë në shfrytëzim sipas pikës (1) një të këtij vendimi, është në sipërfaqe prej 70000m$^2$, Parcela Kadastrale P-71107041-01075-5 e cila gjendet në Z.K pronë shoqërore Komuna e Kamenicës.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale është realizimi i projektit **" Ngritja e Plantacionit me Arrë "** ashtu siç është përcaktuar në ofertën e negociuar. Investimi total duhet të arrij 141,740.00 €, me rastin e funksionalizimit të projektit do të angazhoj plus katër (4) punëtorë nuk guxon të bijë më poshtë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik pa koordinim dhe pajtim me Komunën e Kamenicës, prej momentit që "Hydajet Pireva B.I", fillon me kapacitet të plotë.

4. "Hydajet Pireva B.I" në emër të kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale do t'i paguaj Komunës qira vjetore në vlerë prej 1% të qarkullimit vjetor nga Subjekti "Hydajet Pireva B.I", por jo më pak se çmimi i qirasë së tokës i përcaktuar me rregullore Komunale (EUR/vit).

5. Dhënia e pronës së paluajtshme komunale, edhe në këto raste evidentohet, në regjistrin e të drejtave pronësore.

6. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen, me kontratë të veçantë në mes të kryetarit të komunës dhe Kompanisë "Hydajet Pireva B.I", e cila hartohet dhe nënshkruhet nga palet pas miratimit të Propozimi vendimit të Kryetarit në Kuvend dhe pas aprovimit të ligjshmërisë së vendimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku pjesë përbërse do të jetë edhe Oferta e negociuar, plani i biznesit, plani dinamik dhe projekti ideor, ndërkaq pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet komunës.

7. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës, DPGJK-ja, dhe DUPH-ja.

8. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Qeverisje Lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Zyrës së Informimit;***
- ***Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;***
- ***Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;***
- ***MAPL-së; dhe***
- ***Arikivit***

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 7340
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 05/03 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 05.03.2024**

Bazuar në nenin 12 pika 12.2 shkronja d), neni 14 paragrafi të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092/2019 për për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 të Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, , neni 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h), neni 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.02.2024 miratoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËRMES ANKANDIT PUBLIK - LOKAL "OBJEKTI I SHTËPISË SË KULTURËS "ISA KASTRATI"**

1. Me këtë vendim formohet komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

2. Komisioni nga pika 1 (një) e këtij vendimi ka këtë përbërje:

   **2.1.** Selim Maliqi, anëtar i kuvendit;
   **2.2.** Magbule Kastrati, anëtare e kuvendit;
   **2.3.** Visar Dërmaku, ekzekutivi i komunës;
   **2.4.** Fadil Hoti, ekzekutivi i komunës; dhe
   **2.5.** Sherafedin Vranja, sektori joqeveritar lokal.

3. Ky Komision formohet për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme (Lokal "Objekti i Shtëpisë së Kulturës "Isa Kastrati"), me numër të parcelës kadastrale P-71107041-01981-0, përkatësishtë pjesët të objektit me numër të parcelës kadastrale O-71107041-01553-0-35-0 kati P- pjesë nga hapësira mbrenda Ndërtesës – Shtëpia e Kulturës "Isa Kastrati" Kamenicë, me sipërfaqe prej 400m$^2$, si dhe bodrumi nga e njejta ndërtesë me sipërfaqe 66m$^2$, e cila në Zyrën Komunale Kadastrale evidentohet në emër të P.SH. Kuvendi Komunal Kamenicë, Z.K Kamenicë.

4. Anëtarët e komisionit me shumicë të votive e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.

5. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën (1) një të këtij Vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do ti ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për për Dhënien

në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

6. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Komisionit.

8. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Qeverisje Lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Zyrës së Informimit;***
- ***Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;***
- ***Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;***
- ***Anëtarëve të Komisionit;***
- ***MAPL-së; dhe***
- ***Arikivit***

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAMENICËS 01 KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA KAMENICA

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. U. 01 Nr. Br. 7342

Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 05/03 2024

KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 05.03.2024**

Bazuar në nenin 12, 14 dhe 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, neni 13 paragrafi 1, dhe neni 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 3, neni 8 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.02.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

## Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme Komunale Përmes Ankandit Publik - Lokal "Objekt Shtëpia e Kulturës "Isa Kastrati"

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Kamenicës me numër kadastral P-71107041-01981-0, përkatësishtë pjesët të objektit me numër të parcelës kadastrale O-71107041-01553-0-35-0 kati P- pjesë nga hapësira mbrenda Ndërtesës – Shtëpia e Kulturës "Isa Kastrati" Kamenicë, me sipërfaqe prej 400m$^2$, si dhe bodrumi nga e njejta ndërtesë me sipërfaqe 66m$^2$, e cila në Zyrën Komunale Kadastrale evidentohet në emër të P.SH. Kuvendi Komunal Kamenicë, Z.K Kamenicë.

2. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.

3. Procedurat për dhënjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) viteve, realizohet përmes ankandit publik.

4. Shfrytëzimi pronës së Paluajtëshme Komunale pjesë e objektit të Shtëpisë së Kulturës "Isa Kastrati" do të jetë në kohëzgjatje si në pikën (3) tre të këtij vendimi dhe është pa kompenzim.

5. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe Përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në periudh afatshkurtër të shfrytëzimit.

6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse.

7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Qeverisje Lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Zyrës së Informimit;***
- ***Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;***
- ***Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;***
- ***MAPL-së; dhe***
- ***Arikivit***

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 11286
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 11.04
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 11.04.2024**

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe të nenit 12 paragrafi 2, shkronja (d) në lidhje me nenet 14 paragrafi 1 dhe 17, shkronja (c) si dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ( " Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës " nr.28/2008 ), si dhe nenit 38 të Statutit të Komunës së Kamenicës , dhe nenit 38 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Kamenicës, 01-Nr.20203, i datës 21.06.2023, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.03.2024 miratoi këtë :

**V E N D I M**
**(Për shpalljen e interesit të përgjithshëm)**

**1.** Miratohet vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për parcelat me numër P-00129-0, P-00161-0, P-00162-0, P-00163-0 ,P-00164-0, P-00165-0, P-00184-0, P-00185-0, P-00405-0, P-00406-0 Z.K. RUBOVC, Kamenicë, sipas certifikatave të pronës dhe kopjes së planit. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik është realizimi i projektit **" Lugu i Verdhë, Kamenicë ".**

**2.** Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi duke filluar procedurën e shpronësimit.

**3.** Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronave në librin kadastral, do të jetë Drejtoria për pronë kadastër dhe gjeodezi në Komunën e Kamenicës.

**4.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë e Pronës Gjeodezisë dhe Kadastër në Komunën e Kamenicës.

**5.** Vendimi hyn në fuqi (15) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

**Vendimi t'i dërgohet :** Zyrës së Kryetarit, MAPL- së, DPGJK -së, DUPH-së dhe Arkivit

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 11289
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 11/04/2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 11.04.2024**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe në nenin 5.2 dhe 82 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Nr. 03/L-087, si dhe nenit 38 paragrafi 38.2), të Statutit Sh.0.Nr.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.03.2024 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË PPP "ECOHIGJIENA" (PËR PJESËN PUBLIKE TË KRM "HIGJIENA") NË GJILAN

1. Miratohet vendimi për emërimin e dy anëtarëve në Komisionin Komunal të Aksionarëve në PPP "Ecohigjiena" për pjesën publike të KRM "Higjiena", dhe atë:

   **1.1 Arbnore Beqiraj**
   **1.2 Bleta Hoxha**

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve si në pikën 1 të këtij vendimi i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe pergjegjësive të cilat u janë dhënë me ligj, Komisioni po ashtu do t`i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore si dhe do ti sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes "Ecohigjiena" në interes te Komunës.

3. Komisioni, për punën e kryer do të kompensohet me vendim të veçantë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushojn të vlejnë të gjitha aktet për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në PPP "Ecohigjiena" (për pjesën publike te KRM Higjiena).

5. Per zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektoriat dhe Kryetari i Komunës së Kamenicës, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-së.

6. Ky vendim hynë ne fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhet zyrtare në faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet*: *Vendimi t'i dërgohet:* *Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit,* DFB-së , *MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.***

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS – OPŠTINA KAMENICA
01 KUVENDI I KOMUNËS – SKUPŠTINA OPŠTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 14965
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 10/05
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**

Bazuar në nenin 11 dhe 12 pika 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 24 paragrafi 1 dhe 2, nenit 40 paragrafi 2 shkronja b) dhe c) të (Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale), pastaj bazuar në Ligjin Nr 08/L-235 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Neni 9 pika 7, si dhe kërkesës nr 05/12257 datë 18.04.2024 të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të tejkaluara, si dhe nenit 38 paragrafi 38.2), të Statutit Sh.01 Nr.20203 dt.21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.04.2024 miratoi këtë:

**VENDIM**

PËR BARTJEN E MJETEVE NGA TË HYRAT VETANAKE TË **TEJKALUARA** NGA VITI 2023 NË VITIN 2024

1. Me këtë akt propozohet bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024 në shumën totale prej **256,526.89**

2. Mjetet buxhetore për bartje të propozuara në pikën (1) një të këtij propozim akti do të shpërndahen :

3. **Bartja mjeteve nga të hyrat vetanake të tejkaluara nga viti 2023 në vitin 2024 në shumë prej 256,526.89€**

**Në kategorinë e shpenzimeve kapitale , shuma prej 256,526.89 €**

- **Zyra e kryetarit (16029), kodi funksional (0111), shuma prej 99,785.79€**
  1."Participimi me Donator "Kodi i projektit 52633 shuma prej 99,785.79€

- **Infrastruktura Publike(18189) ,kodi funksional (0451) shuma prej 1,760.93€**
  "Ndërtimi i pritoreve te autobusve ne Hogosht, Shipashnicë e Poshtme, Hodonoc, Topanicë, Koretin, Kopërnicë dhe Petroc kodi i projektit 55072 shuma prej 1,760.93€

- **Planifikimi Urban dhe Inspekcioni (66450) ,kodi funksional(0620) shuma prej 154,980.27€**
  1. "Asfaltimi i rrugeve ne Hodonoc" kodi i projektit 54877 shuma prej 50,000.00€
  2. "Asfaltimi i rrugeve lokale ne Petroc" kodi i projektit 54880 shuma prej 18,816.53€
  3. "Asfaltimi i rrugeve ne fshatin Shipashnicë e Ulët, Pishat rr. Kranidell dhe rruga Bahri Fazliu "kodi i projektit 52880, shuma prej 6,647.00€ project nga viti 2023
  4. "Asfaltimi i rrugeve lokale në Topanicë ", kodi i projektit 54830,shuma prej 4,620.00€
  5. "Asfaltimi i rrugeve ne Koretin ", kodi i projektit 54835,shuma prej 2,349.00€
  6. "Asfaltimi i rrugeve ne Muciverc", kodi i projektit 54856,shuma prej 7,435.50€

7. "Renovimi i nderteses sociale ne Kamenice ", kodi i projektit 53464, shuma prej 6,973.00€, projekt nga viti 2023

8. "Ndërtimi urave metalike beton për këmbësor në Koretin, Hajnoc, Berivojcë, Karaçevë", kodi i projektit 55078, shuma prej 41,999.14€

9. "Ndërtimi i urave të vogla nga betoni , zgjerimi dhe riparimi i urave ekzistuese në Rogaçicë, Kamenicë, Koretin, Berivojcë , Krilevë , Kopernicë" kodi i projektit 55074, shuma prej 16,140.00€

4. Pas miratimit të këtij propozim akti nga Kuvendi i Komunës, për zbatimin e këtij Vendimi, kujdeset Kryetari i Komunës.

5. Propozim aktit i bashkangjitetet: Kërkesa të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.

6. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Ilridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 14960
Nr. i faq. 2 Data: Datum: 10/05
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**

Bazuar në nenin 11, 12, dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe neni 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 3, neni 8 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.04.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE PËRMES ANKANDIT PUBLIK

1. Me këtë Vendim, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtëshme të Komunës së Kamenicës, në shfrytëzim afatshkurtër përsonave fizik dhe juridik si në vijim:

   **1.1.** Njësia kadastrale me nr. P-71107063-00292-0, vendi i quajtur, Kodra e Makovishte me sipërfaqe prej 82696 $m^2$, në zonën kadastrale në Poliçkë, Komuna e Kamenicës.

   **1.2.** Njësia kadastrale me nr. P-71107063-00342-0, vendi i quajtur, Kodra e Makovishte me sipërfaqe prej 47993 $m^2$, në zonën kadastrale në Poliçkë, Komuna e Kamenicës.

2. Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme Komunale është afatshkurtër me kohëzgjatje prej 5 viteve me destimin kultivimi i kulturave bujqësore me qëllim të shfrytëzimit nga ana e personave fizik apo juridik.

3. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.

4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës Komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i Komunës nga prona Komunale.

5. Procedurat për dhënien e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënien në

Shfrytëzim dhe Kembim të Prones së Palujtshme të Komunës.

6. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshëme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfitusit të marrjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme në periudhë afatshkurtër të shfrytëzimit me të drejtë të shkëputjes së kontratës edhe para afatit nëse prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllime të cekura në nenin 2 të këtij vendimi.

7. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë përkatëse.

8. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 14963
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum 10/05
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**

Bazuar në nenin 11, 12, dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe neni 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 3, neni 8 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.04.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE PËRMES ANKANDIT PUBLIK

1. Me këtë Vendim, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtëshme të Komunës së Kamenicës, në shfrytëzim afatshkurtër përsonave fizik dhe juridik si në vijim:

   **1.1.** Njësia kadastrale me nr. P-71107041-01985-0, vendi i quajtur, Qendra Tregtare Zejtare me sipërfaqe prej 6208 m$^2$, në zonën kadastrale në Kamenicë, Komuna e Kamenicës.

2. Nga Parcela e cekur në pikën **1.1** të këtij Vendimi, jepen në shfrytëzim S - 85 m$^2$.

3. Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme Komunale është afatshkurtër me kohëzgjatje prej 15 vite.

4. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.

5. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës Komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i Komunës nga prona Komunale (përfitimi material - qiraja).

6. Procedurat për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Kembim të Prones së Paluajtshme të Komunës.

7. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshëme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfitusit të marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në periudhë afatshkurtër.

8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë përkatëse.

9. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Elridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 14948
Nr. i faq. 2 Data: Datum: 10/05
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**
Bazuar në nenin 12 pika 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092/2019 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 të Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 38 paragrafi 38.2), të Statutit Sh.01 Nr.20203 dt.21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.04.2024 miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËRMES ANKANDIT PUBLIK

**1.** Me këtë Vendim formohet komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

**2.** Komisioni nga pika 1 (një) e këtij vendimi ka këtë përbërje:

**2.1.** Hasan Krasniqi, anëtar i kuvendit
**2.2.** Florim Kryeziu, anëtar i kuvendit
**2.3.** Ilirida Zubaku, nga ekzekutivi i komunës
**2.4.** Edon Dërmaku, nga ekzekutivi i komunës, dhe
**2.5.** Sherafedin Vranja, nga sektori joqeveritar lokal.

**3.** Ky Komision formohet për dhënien në shfrytëzim e pronës së paluajtëshme të Komunës së Kamenicës, në shfrytëzim afatshkurtër përsonave fizik dhe juridik si në vijim: Njësia kadastrale me nr. . P-71107041-01985-0, vendi i quajtur, Qendra Tregtare Zejtare me sipërfaqe prej 6208 $m^2$, në zonën kadastrale në Kamenicë, Komuna e Kamenicës.

**4.** Nga Parcela e cekur në pikën **3** të këtij Vendimi, jepen në shfrytëzim S - 85 $m^2$.

**4.** Afati kohorë për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme Komunale është afatshkurtër me kohëzgjatje prej 15 viteve.

**5.** Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin Kryesuesin e Komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.

**6.** Komisioni në përbërje të cekur si në pikën (2) dy të këtij Vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do ti ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për për Dhënien në

shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**7.** Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.

**8.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Komisionit.

**9.** Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Anëtarëve të Komisionit, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 14956
Nr. i faq. 2 Data: Datum: 10/05
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**

Bazuar në nenin 12 pika 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092/2019 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 të Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 38 paragrafi 38.2), të Statutit Sh.01 Nr.20203 dt.21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.04.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËRMES ANKANDIT PUBLIK

**1.** Me këtë Propozim - Vendim paraprak formohet komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

**2.** Komisioni nga pika 1 (një) e këtij vendimi ka këtë përbërje:

**2.1.** Lirim Kryeziu, anëtar i kuvendit
**2.2.** Rabit Dërmaku, anëtar i kuvendit
**2.3.** Ilirida Zubaku, nga ekzekutivi i komunës
**2.4.** Edon Dërmaku, nga ekzekutivi i komunës, dhe
**2.5.** Sherafedin Vranja, nga sektori joqeveritar lokal.

**3.** Ky Komision formohet për dhënien në shfrytëzim e pronës së paluajtëshme të Komunës së Kamenicës, në shfrytëzim afatshkurtër përsonave fizik dhe juridik si në vijim:

**3.1.** Njësia kadastrale me nr. P-71107063-00292-0, vendi i quajtur, Kodra e Makovishte me sipërfaqe prej 82696 $m^2$, në zonën kadastrale në Poliçkë, Komuna e Kamenicës.

**3.2.** Njësia kadastrale me nr. P-71107063-00342-0, vendi i quajtur, Kodra e Makovishte me sipërfaqe prej 47993 $m^2$, në zonën kadastrale në Poliçkë, Komuna e Kamenicës.

**4.** Afati kohorë për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme Komunale është afatshkurtër me kohëzgjatje prej 5 viteve.

5. Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin Kryesuesin e Komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.

6. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën (2) dy të këtij Vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do ti ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

7. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.

8. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Komisionit.

9. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Anëtarëve të Komisionit, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 14962
Nr. i faq. Br. str. 5 Data: Datum: 10/05
KAMENICË/A 2024

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**

Në bazë të nenit 12 , paragrafi 12.2, pika d), nenit 17 pika (b), neni 40 shkronja (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008);, Nenit 5 Paragrafi 1 , nënparagrafi 1.2 pika 1.2.2, Neni 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 Neni 11 paragrafi 1.3, Nenit 16 dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, datës 31.07.2013, Udhëzimit Administrativ neni Nr. 11/ 2015, Mbi elementet dhe kerkesat për Hartimin , Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, neni 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.04.2024 miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR HARTIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË KAMENICËS

### Neni 1

### Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

**Miratohet vendim fillimin e hartimit Hartës Zonale të Komunës së Kamenicës**

### Neni 2

### Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Harta zonale e komunës, është një dokument shumë sektorial,që përmes grafikoneve,fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin , shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit, të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e komunës, për periudhën së tetë (8) vjeçare.

### Neni 3

### Qëllimi i hartimit

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Shërbimit të Kuvendit;***
- ***Zyrës së Përkthimeve;***
- ***Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;***
- ***Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat;***
- ***MAPL-së; dhe***
- ***Arkivit.***

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS OPŠTINA KAMENICA
01 KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE

Lindon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

*Arsyetim*

1. **Mungesa e mjekut**: Aktualisht, QMF Qendër nuk ka në dispozicion një mjek të licencuar për të ofruar shërbime mjekësore të domosdoshme për pacientët.

2. **Mungesa e infrastrukturës**: Objektet dhe pajisjet mjekësore në QMF Qendër janë të papërshtatshme dhe nuk plotësojnë standardet e kërkuara për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore.

3. **Largësia e QKMF-së nga QMF Qendër**: Distanca ndërmjet QKMF-së dhe QMF Qendër është më pak se 5 kilometra, çka e bën të panevojshme ekzistencën e dy qendrave të afërta shëndetësore.

4. **Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) nr. 04/2020**: Sipas këtij udhëzimi, infermierët nuk kanë të drejtë të japin terapi parenterale pa prezencën e mjekut. Duke qenë se QMF Qendër nuk ka mjek, kjo qendër nuk i plotëson kriteret për kryerjen e shërbimeve shëndetësore sipas udhëzimeve dhe ligjeve në fuqi.

Në bazë të kompetencave të dhëna nga statuti i QKMF-së dhe udhëzimet administrative, propozoj mbylljen e QMF Qendër për shkaqet e sipërpërmendura.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 21034
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 02/07
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 01.07.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d), nenit 24, paragrafi 1 dhe nenit 40, paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 4 dhe 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe Kërkesës Sh.01.Nr.17660 të datës 29.05.2024 të parashtruar nga Kryqi i Kuq i Kosovës dega në Kamenicë, Kuvendi i Komunës së Kamenicës, në mbledhjen e mbajtur me 21.06.2024, merr këtë:

**VENDIM**
**PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 1,990.oo €.**

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare në shumë prej 1,990.oo € nga Buxheti i Komunës së Kamenicës për perkrahjen e Kryqit të Kuq Kamenicë në xhirollogarinë e Kryqit të Kuq dega në Kamenicë: [illegible] në NLB Bankë në Kamenicë.

2. Mjetet financiare në shumën prej 1,990.oo € lejohen nga kategoria e shpenzimeve për subvencioneve dhe transfere, nga Programi Zyra e Kryetarit (Kodi 16029).

3. Zbatimi i vendimit bëhet me kontratë në mes të drejtorisë përkatëse dhe Kryqit të Kuq.

4. Implementimin e këtij Vendimi e bën Drejtoria për Financa dhe Buxhet, kurse për zbatimin e tij kujdeset Kryetari i Komunës.

5. Këtij Vendimi i bashkangjitet Kërkesa Sh.01.Nr.17660 të datës 29.05.2024 të parashtruar nga Kryqi i Kuq i Kosovës dega në Kamenicë.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi iu dërgohet:** *Zyrës së Kryetarit, Shëbimit të Kuvendit, Zyrtarit për Përkthime, Zyrës së Informimit, MAPL-së, Kryqi i Kuq dega në Kamenicë dhe QShQ-Arkivit*

**Faridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS – OPŠTINA KAMENICA
01 KUVENDI I KOMUNËS – SKUPŠTINA OPŠTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETAREVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 21036
Data: 02/07 Datum:
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 01.07.2024**
Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, nenit 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, nenit 53 paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithëshme Administrative, nenit 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe kërkesës Nr.020-194/7 dt: 13.06.2024 të MAPL-së, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.06.2024, merr këtë:

# V E N D I M

**Për Plotësim-ndryshimin e Vendimit Bazë Sh.01.Nr.7342 i datës 05.03.2024 .**

1. **Plotësohet dhe ndryshohet** pika 4 e Vendimit bazë Sh.01.Nr.7342 i datës 05.03.2024 , hiqet teksti 'se prona do jepet pa kompenzim' dhe riformulohet si në vijim :

   **1.1** Prona jepet me kompenzim sipas Ligjit Nr.06/L-92 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtëshme të Komunës.

   **1.2** Sipërfaqja prej 66m2 është pjesë nga e njëjta ndërtesë me numër kadastral P-71107041-01981-0, përkatësishtë pjesët të objektit me numër të parcelës kadastrale O-71107041-01553-0-35-0 kati P-cila në Zyrën Komunale Kadastrale evidentohet në emër të P.SH. Kuvendi Komunal Kamenicë, Z.K Kamenicë.

2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të hapësirë (bodrumit) si në pikë 1 paragrafi 1.2, është zhvillimi ekonomik lokal si dhe rritja e të hyrave të Komunës.

3. Ky Vendim është pjesë përbërse e Vendimit bazë Sh.01.Nr.7342 i datës 05.03.2024 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Shëbimit të Kuvendit, Zyrtarit për Përkthime, Zyrës së Informimit, MAPL-së dhe QSHQ- arkivi.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 21037
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 02/07
KAMENICË/A 2024

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 01.07.2024**

Bazuar në nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d), nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6 nën paragrafi 2.1 dhe neni 8 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 12,13 dhe 15 të Ligjit Nr. 04/-L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim, nenit 38 të Statutit Sh.02.Nr.20203 i dates 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregulltë të mbajtur më 21.06.2024 merr këtë:

**V E N D I M PËR NISMËN**
**PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL ME KOMUNËN E RANILLUGUT**
**Në fushën e Ofrimit të Shërbimeve të Zjarrëfiksve, Mamografisë dhe Realizimin e Studimit të fizibilitetit për ujë të pijes për Ranillug dhe fshati Petrit**

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me Komunën e Ranillugut në fushën e Zjarrëfiksve, Mamografisë dhe Realizimin e Studimit të fizibilitetit për ujë të pijes për Ranillug dhe Petrit.

2. Qëllimi i bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Komunës së Ranillugut do të bëhet në fushat e ndihmes reciproke për shërbimet si në pikën (1) një të këtij vendimi.

3. Autorizohet Kryetari i Komunës që në bashkpunim me Komunën e Ranillugut të fillojn negociatat për hartimin e marrjevshjes dy paleshe ndërkomunale.

4. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi bazën e ndihmës reciproke me ofrimin e resurseve humane dhe materiale në rast të paraqitjes së nevojave për ofrimin e shërbimeve në fushat përkatëse.

5. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim vendimin për miratimin e nismës, nga Kuvendi i Komunës.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Shëbimit të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Shërbime Publike Ambient dhe Inspektorat, MAPL-së dhe OSHQ- arkivi.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

*Arsyetim*

Nismat për vendosjen e bashkëpunimit ndër komunal mund t'i marrin organet komunale, institucionet qëndrore dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me fushën e vetëqeverisjes lokale.

Komunat hyjnë në bashkëpunim me komunat tjera në funksion të zhvillimit më të shpejtë ekonomik lokal, të efikasitettit dhe efektivitetit të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit bashkëpunimi komunal ndërkombëtaar është i kufizuar vetëm në aspektin administrativë dhe teknik.

Komunat e përfshra në cilën do formë të BNK veç e veç dhe bashkarisht mbajnë përgjegjësi juridike për të gjitha veprimet dhe aktet juridike që rezultojnë nga bashkëpunimi në fjalë.

Poashtu komunat janë të kufizuara të ndërmarrin veprimet për lidhjen e bashkëpunimit ndërkomunal dhe bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, në rast se dalin jashtë kompetencave vetanake të përcaktuara me legjislacionin për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës, çdo bashëpunim duhet të ketë për qëllim interesin e përbashkët të komunave.

Bashkëpunimi ndër komunal në Republikën e Kosovës është normuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Bashkëpunim ndër komunal si dhe aktet tjera për zbatimin e këtij ligji.

Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta lidhur me ushtrimin e kompetencave të tyre vetanake sipas Ligjit për vetëqeverisjen Lokale, dy apo më shumë komuna kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi në pajtim me parimet, format kushtet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin e sipër cekur.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETAREVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 21038
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 02/07
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 01.07.2024**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d) dhe neni 40 e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 6 paragrafi 2 i Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2013"), nenit 4 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.7 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, nenit 38 të Statutit Sh.02.Nr.20203 i dates 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe Draft Plani Sh.09.18126 i dates 03.06.2024 i Transportit për Komunën e Kamenicës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.06.2024, merr këtë:

# VENDIM

## Për miratimin e Planit të transportit rrugor lokal në Komunën e Kamenicës 2024-2028

1. Me këtë vendim miratohet Plani i transportit rrugor lokal në Komunën e Kamenicës 2024-2028.

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i transportit rrugor lokal në Komunën e Kamenicës 2024-2028.

3. Per zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria per Shërbime Publike në Komunen e Kamenicës.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Shëbimit të Kuvendit, Zyrtarit për Përkthime, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Shërbime Publike Ambient dhe Inspektorat, MAPL-së dhe QSHQ- arkivi.*

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS – 01 KUVENDI I KOMUNËS – SKUPŠTINA OPŠTINA KAMENICA

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 24404
Nr. Prot. 2 Data: Datum: 30/07 2024
KAMENICE/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi i Komunës**

**Datë/ 29.07.2024**

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), neni 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 15,16 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, neni 30 i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.03./L-221,Ligjin Nr.04/L-116, Ligjin Nr.04/L-194, Ligjin Nr.05/L-063, dhe Ligjin Nr.05/L-007 dhe nenit 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01 Nr.20203/dt.21.06.2023 të Komunës së Kamenicës si dhe Kërkesës Sh.02.Nr.23537 e datës 24.07.2024 për Transfer dhe Rialokim e parashtruar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të dates 29.07.2024 mori këtë;

## VENDIM
### Për transfer dhe rialokim të mjeteve

1. Miratohet vendimi për transfer dhe rialokim të mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kategori për Subvencione dhe **shpenzimeve kapitale** për vitin 2024.

2. Mjetet për transfer dhe rialokim sipas pikës 1 të këtij vendimi janë si vijon:

3. Transferet/Rialokimet e mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve nga fondi burimor 10.

***Nga:***Programi Administrata dhe Personeli (163) nenprogrami Administrata (16329) ne shume prej 15,000.00.00€ fondi burimor 10
***Nga:***Programi Buxhet dhe Financa(175) nenprogrami Buxhetimi(17529) ne shume prej 2,950.00€ fondi burimor 10
***Nga:***Programi Zyra Komunale për Komunitete (195) nenprogrami Zyra Komunala per Komunitete dhe Kthim (19645) ne shume prej 740.00€ fondi burimor 10
***Nga:***Programi Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim rural (470) nenprogrami Bujqësia (47029) ne shume prej 4,400.00€ fondi burimor 10
***Nga:***Programi Kadastra dhe Xheodezia (650) nenprogrami Shërbimet Kadastrale (65145) ne shume prej 1,649.00€ fondi burimor 10
***Nga:***Programi Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale (755) nenprogrami Shërbimet Sociale (75641) ne shume prej 2,200.00€ fondi burimor 10
***Nga:***Programi Administrata dhe Shkenca (920) nenprogrami Administrata (92145) ne shume prej 20,000.00€ fondi burimor 10

**Në Transferet/Rialokimet e mjeteve në kategori të Subvencioneve dhe Transfereve**

Në Programi Zyra e Kryetarit (160) nenprogrami Zyra e Kryetarit (16029) ne shume prej 46,939.00€, fondi burimor 10

4. Nga Transferet/Rialokimet e mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve nga fondi burimor 21.

*Nga:*Programi Zyra e Kryetarit (160) nenprogrami Zyra e Kryetarit (16029) ne shume prej 7,490.00€ fondi burimor 21
*Nga:*Programi Administrata dhe Personeli (163) nenprogrami Administrata (16329) ne shume prej 6,735.00.00€ fondi burimor 21
*Nga:*Programi Buxhet dhe Financa(175) nenprogrami Buxhetimi(17529) ne shume prej 749.00€ fondi burimor 21
*Nga:*Programi Shërbimet Publike Mbrojtja ,Mbrojtja civile (180) nenprogrami Infrastruktura Publike (18189) ne shume prej 10,260.00€ fondi burimor 21
*Nga:*Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nenprogrami Planifikimi urban dhe Inspekcioni (66450) ne shume prej 2,998.00€ fondi burimor 21
*Nga:*Programi Administrata dhe Shkenca (920) nenprogrami Administrata (92145) ne shume prej 6,630.00€ fondi burimor 21

**Në Transferet/Rialokimet e mjeteve në kategori të Subvencioneve dhe Transfereve**

Në Programi Zyra e Kryetarit (160) nenprogrami Zyra e Kryetarit (16029) ne shume prej 34,862.00€, fondi burimor 21

5. Transferet/Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 22 shuma prej 1,829.88€.

- **Nga Projektet:**

  1. Projekti "Ndërtimi i trotuareve ne qytetin e Kamenices dhe fshatrat" Programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660) nënprogrami Planifikimi Urban dhe Inspekcioni (66450) kodi i projektit 52839 në shumë prej 1,121.50€.
  2. Projekti "Ndertimi i stadiumit ne Hogosht " Kulturë Rini dhe Sport (850) nënprogrami Sherbimet Kulturore (85029) kodi i projektit 51134 në shumë prej 708.38€

- **Në projektin ekzistues** "Renovimi i AMF-ve Busavatë,Topanicë,Karaqevë,Roganë dhe Hogosht " në programin Shendetesi dhe Mirëqenja Sociale (730) nënprogrami Administrata (73038) kodi i projektit ekzistues 55068 në shumë prej **1,829.88€**

6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.

7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

**Vendimi u dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Kuvendit;
- MAPL-së
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa ; dhe
- Arkivit.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Liridon Kastrati**

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 24401
Nr. i faq. 26 Data: Datum: 30/07
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 30.07.2024**
Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d) dhe neni 40 e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 6 paragrafi 2 i Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2013"), nenit 4 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.7 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, nenit 38 të Statutit Sh.02.Nr.20203 i dates 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe Draft Plani Sh.09.18126 i dates 03.06.2024 i Transportit për Komunën e Kamenicës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2024, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për miratimin e Planit të transportit rrugor lokal në Komunën e Kamenicës 2024-2028**

1. Me këtë vendim miratohet Plani i transportit rrugor lokal në Komunën e Kamenicës 2024-2028.

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i transportit rrugor lokal në Komunën e Kamenicës 2024-2028.

3. Per zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria per Shërbime Publike në Komunen e Kamenicës.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Shëbimit të Kuvendit, Zyrtarit për Përkthime, Zyrës së Informimit, Drejtorisë për Shërbime Publike Ambient dhe Inspektorat, MAPL-së dhe QSHQ- arkivi.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS – OPŠTINA KAMENICA
01 KUVENDI I KOMUNËS – SKUPŠTINA OPŠTINE

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TE QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. Br. 01 Nr. Br. 28650
Nr. faq. 1 Data: Datum: 09/09
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 09.09.2024**

Bazuar në nenet 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenit 53 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenit 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së Nr.020 – 435/4, dt. 04.07.2024 për Vendimin Sh.02.Nr.21033 të dt. 02.07.2024 Për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

## Për Shfuqizim të Vendimit Sh.02.Nr.21033 të dt. 02.07.2024 Për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër

1. **SHFUQIZOHET** Vendimi Sh.02.Nr.21033 të dt. 02.07.2024 Për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi Sh.02.Nr.21033 të dt. 02.07.2024 K.K. Kamenicë, Për Mbylljen e Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF-së) Qendër.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet***: ***Vendimi t'i dërgohet:*** *Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit,* DSH-së , *MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TE QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 28654
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 09/09
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 09.09.2024**
Bazuar në nenet 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenit 53 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenit 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së Nr.020 – 435/11, dt. 15.08.2024 për Vendimin Sh.02.Nr.21061 të dt. 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Veton Kallaba B.I" me procedurë të negocimit të ofertës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.08.2024 miratoi këtë:

**V E N D I M**

**Për Shfuqizim të Vendimit Sh.01.Nr.21061 të datës 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Veton Kallaba B.I" , me procedurë të negocimit të ofertës**

1. **SHFUQIZOHET** Vendimi Sh.01.Nr.21061 të datës 02.07.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Veton Kallaba B.I" , me procedurë të negocimit të ofertës.

2. Pas shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të cekur në pikën (1) një të këtij vendimi nga MAPL-së me shkresen Nr.020/435/11 të datës 15.08.2024, konstaton se akti në fjalë duhet të rishqyrtohet nga Kuvendin Komunal Kamenicë dhe të harmonizohet me legjislacionin në fuqi, Andaj, Vendimi si në pikën (1) një, Shfuqizohet.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet*: *Vendimi t'i dërgohet*:** *Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit,* DZHED-së , *MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAMENICËS 01 KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA KAMENICA SKUPŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 28717
Nr. i faq. Br. str. 3 Data: Datum: 09/09 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 09.09.2024**

Bazuar në nenet 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenit 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së Nr.020 – 435/10, dt. 15.08.2024 për Vendimin Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë:30.08.2024 miratoi këtë:

**V E N D I M**

1. Me këtë Vendim bëhet shfuqizimi i pjesërishëm i Vendimit Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.

2. **SHFUQIZOHET** pika 1.2 nga Vendimi Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024, si në vijim:

   **2.1** Pika 1 paragrafi 1.2 *(Njësia kadastrale me nr. P-71107079-01372-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" me sipërfaqe prej 4872 m$^2$, në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës)* të Vendimit Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.

3. Nga parcela e cekur në pikën 1.3 të vendimit bazë përkatësisht njësia kadastrale me nr. P-71107079-01371-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" jepen në shfrytëzim sipërfaqja prej 13183 m$^2$, në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës, ndërsa sipërfaqja prej 19000 m$^2$ nga sipërfaqja e përgjithshme e njësisë kadastrale mbetet pronë komunale si në kopjen e planit që është në shtojcë të këtij vendimi.

4. Mbetet në fuqi pjesa tjetër e Vendimit Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim e vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.

5. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa mbikëqyrjen për zbatimin e tij e bënë Kryetari i Komunës.

6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Vendimi Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës.

7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Shërbimit të Kuvendit;***
- ***Zyrës së Përkthimeve;***
- ***Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;***
- ***Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;***
- ***MAPL-së; dhe***
- ***Arkivit.***

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E KAMENICËS – 01 KUVENDI I KOMUNËS – REPUBLIKA KOSOVA – SKUPŠTINA OPŠTINE – OPŠTINA KAMENICA

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

**A r s y e t i m**

Vendimi Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë përmes Procedurës së Negocimit, Në kuadër të detyrimeve tona për të siguruar përputhshmërinë e vendimeve të Komunës me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe në vijim të kërkesës dhe rekomandimeve të pranuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), kemi shqyrtuar Vendimin Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, me të cilin u miratua dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë përmes procedurës së negocimit. Gjatë këtij procesi, është identifikuar se pika 1.2 e këtij vendimi nuk është në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 06/1-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Konkretisht, janë vërejtur këto mangësi:
Mospublikimi në Wefaqen Zyrtare të Komunës Parcela kadastrale nr. 71107079-01372-0 nuk është publikuar në listën e përgjithshme dhe të veçantë të pronave për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024 në webfaqen zyrtare të komunës, siç kërkohet nga neni 13 i Ligjit Nr. 06/L-092. Ky publikim është një kërkesë thelbësore për të garantuar transparencën dhe ligjshmërinë e procedurës së dhënies së pronës në shfrytëzim.
Mungesa e Harmonizimit me Dokumentet e Planifikimit Hapësinor Parcela e përmendur nuk është argumentuar si në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) ose Hartën Zonale, gjë që është një kërkesë ligjore sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 06/L-092. Qëllimi i shfrytëzimit të pronës komunale duhet të jetë

i harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor, për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm dhe interesin publik të Komunës. Bazuar në këto mangësi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar ndërmarrjen e masave të duhura për rishqyrtimin e aktit dhe harmonizimin e tij me legjislacionin në fuqi. Në përputhje me këtë rekomandim kemi shfuqizuar pikën 1.2 të Vendimit Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës. Ky shfuqizim është i nevojshëm për të adresuar mangësitë e identifikuara dhe për të siguruar që procedura e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim të kryhet në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë.
Në përfundim, shfuqizimi i pikës 1.2 të vendimit është një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit të këtij akti me legjislacionin në fuqi, duke shmangur shkeljet ligjore dhe duke ruajtur integritetin e procesit vendimmarrës në Komunën e Kamenicës.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Nr. U. Br. 01 Nr. Br. 21059
Nr. faq. Br. str. 2 Data: Datum: 02/07 2024
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 02.07.2024**

Bazuar në nenet 12 dhe 14 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenin 11 të për dhëniene në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Qarkorën Ligjore për procedurën e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, neni 23 i Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nxjerr nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 10.08.2020, nenet 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragraafi 5.1 shkronja h) dhe 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.06.2024 miratoi këtë:

**V E N D I M**
**Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negocimit të ofertës**

1. Me këtë vendim "Qëndresa Gagica Hajdari B.I" - (Cetifikata e Regjistrimit: 812163468), me përfaqësuese Qëndresa Gagica Hajdari nga Koretini, Komuna e Kamenicës, **i IPET** në shfrytëzim afatgjatë prej njëzetë (20) vitesh, pronat e paluajtshme të Komunës, sipas procedurës së negocimit.

   **1.1.** Njësia kadastrale me nr. P-71107079-00002-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" me sipërfaqe prej 167132 m$^2$, në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës.

   **1.2.** Njësia kadastrale me nr. P-71107079-01372-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" me sipërfaqe prej 4872 m$^2$, në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës.

   **1.3.** Njësia kadastrale me nr. P-71107079-01371-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" me sipërfaqe prej 32183 m$^2$, në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës.

2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale është realizimi i projektit **"Ndërtimi i fermës së përzier"** ashtu siç është përcaktuar në ofertën e negociuar. Investimi total duhet të arrij 320,000.00 €, me rastin e funksionalizimit të projektit do të angazhoj plus katër (4) punëtorë nuk guxon të bijë më poshtë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik pa koordinim dhe pajtim me Komunën e Kamenicës, prej momentit që "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", fillon me kapacitet të plotë.

3. "Qëndresa Gagica Hajdari B.I" në emër të kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale do t'i paguaj Komunës qira vjetore në vlerë prej 1,160.00 € të qarkullimit vjetor nga Subjekti "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", por jo më pak se çmimi i qirasë së tokës i përcaktuar me rregullore Komunale (EUR/vit).

4. Dhënia e pronës së paluajtshme komunale, edhe në këto raste evidentohet, në regjistrin e të drejtave pronësore.

5. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen, me kontratë të veçantë në mes të kryetarit të komunës dhe Kompanisë "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", e cila hartohet dhe nënshkruhet nga palet pas miratimit të Propozimi vendimit të Kryetarit në Kuvend dhe pas aprovimit të ligjshmërisë së vendimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku pjesë përbërse do të jetë edhe Oferta e negociuar, plani i biznesit, plani dinamik dhe projekti ideor, ndërkaq pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet komunës.

6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës, DPGJK-ja, dhe DUPH-ja.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Kamenicë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr - 28/2008"), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Zyrës së Informimit;***
- ***Zyrës së Përkthimeve;***
- ***Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;***
- ***Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;***
- ***MAPL-së; dhe***
- ***Arikivit***

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 25141
Nr. i faq. 1 Data Datum: 06/08 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.299 dt. 06.08.2024**

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 te Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28 te dt. 04.06.2008), nenit 7 të Rregullores Komunale Sh.01Nr.31251 datë 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve në Bujqësi, pastaj Thirrjes Publike Sh.12 Nr.21532 datë 05.07.2024, nenit 70 të Statutit Sh.02.nr.20203 i dates 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe kërkesës Nr.24990/05.08.2024 parashtruar nga Drejtori i DBPZHR-së z.Shpend Morina, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve në bujqësi për projektin "Furnizim i fermerëve me mekanizëm bujqësor për minoritete"2024, në përbërje nga këta anëtarë:

   **1.1** Bektesh Dërmaku (DBPZHR), Kryesues;
   **1.2** Faik Avdyli (DBPZHR), anëtar;
   **1.3** Kaltrina Kryeziu(BPZHR), anëtare;
   **1.4** Edon Canaj (DFB), anëtar;
   **1.5** Lavdim Klaiqi (Komuniteti), anëtar; dhe
   **1.6** Liridon Rexhepaj (ZK), anëtar rezervë.

2. Komisioni ka për detyrë të bëj shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për projektin sipas pikes (1) të këtij vendimi, kritereve të thirrjes publike Sh.12 Nr.21532 datë 05.07.2024 dhe dispozitave të Rregullores Komunale Sh.01Nr.31251 datë 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve në Bujqësi si dhe akteve ligjore/nënligjore në fuçi.

3. Komisioni fillon me punë menjëherë pas pranimit të vendimit.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

***Vendimi t'i dorëzohet:*** Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Anëtarëve të Komisionit, dhe Arkivit.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

**Kuvendi i Komunës së Kamenicës**

Në bazë të nenit 11, 12, paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit Nr 03/L-040, Për Vetëqeverisje Loklale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/12, qershor 2008) neni 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës lidhur me nenin 24 dhe 25 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, Kërkesës 01/0917 të datës 27.09.2024 e parashtruar nga MPB Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, neni 3 paragrafi 3.7 neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit 01.Nr.20203 të dates: 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.09.2024 miratoi këtë:

**V E N D I M**

**Për dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës për Policinë e Republikës së Kosovës**

1. Me këtë Vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Kamenicës, në bazë të Kërkesës së parashtruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, kërkesës 01/0917 të datës 27.09.2024 e parashtruar nga MPB Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, pa procedurë të rregullt të Konkurrimit bazuar në ligjet ne fuqi.

2. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, ish Objekti i Nënstacionit të Zjarrëfikësve dhe Shpëtimit duke përfshirë edhe parkingjet në fshatin Muçivërc, dhe i ka këto karakteristika parcela me numër të ngastrës katastrale P-711107055-01154-1 me sipërfaqe prej 820 m², P.SH. Kuvendi Komunal Kamenicë.

3. Qëllimi i dhënjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin (2) të këtij vendimi është shfrytëzimi i ish Objekti i Nënstacionit të Zjarrëfikësve dhe Shpëtimit duke përfshirë edhe parkingjet në fshatin Muçivërc, pasi që gjendja e objektit të SPMK Muçivërc është shumë në gjendje të keqe për shkak të vjetërsisë së objektit fakt ky i konstatuar edhe nga ana e Inspektorëve Sanitarë, dhe ish Objekti i Nënstacionit të Zjarrëfikësve dhe Shpëtimit në fshatin Muçivërc është në gjendje të mirë dhe më i përshtatshëm për Policinë e Republikës së Kosovës SPMK Muçivrcë.

4. Afati kohor për dhënje në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të përshkruar në nenin (2) të këtij vendimi jepet në shfrytëzim prej tre (3) vitesh, me mundesi vazhdimi.

5. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në nenin (2) të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim. Me qëllim të rikthimit të objektit Komunal në shfryrtëzim për Policinë e Republikës së Kosovës.

6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse.

7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i'u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Shërbimit të Kuvendit;***
- ***Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;***
- ***Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor; dhe***
- ***MAPL-së;***
- ***Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë; dhe***
- ***Arkivit.***

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Liridon Kastrati**

**A r s y e t i m**

Komuna e Kamenicës, duke marrë në konsideratë kërkesën e drejtuar nga Policia e Kosovës për shfrytëzimin e përkohshëm të ish-objektit të Nënstacionit të zjarrfikësve dhe shpëtimit në fshatin Muçivërc, bazuar në ligjet dhe rregullat në fuqi, propozon dhënien e këtij objekti për një periudhë prej tri (3) viteve, me mundësi vazhdimi.

Sipas kërkesës së Policisë së Kosovës, objekti aktual i Nënstacionit Policor në Muçivërc nuk përmbush kushtet për funksionim dhe është në gjendje të papërshtatshme për personelin policor. Objekti është i vjetër dhe qëndrimi i mëtejshëm rrezikon shëndetin dhe mirëqenien e stafit. Demolimi i këtij objekti dhe ndërtimi i një të riu është i domosdoshëm, por për një zgjidhje të përkohshme kërkohet zhvendosja e personelit në një objekt që i plotëson kushtet minimale të funksionimit.

Ish-objekti i Nënstacionit të zjarrfikësve dhe shpëtimit, sipas vlerësimit të Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve të Policisë së Kosovës, i plotëson kushtet teknike për strehimin dhe funksionimin e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit dhe Nënstacionit Policor në Muçivërc. Ky objekt do të përshtatet për nevojat e përkohshme të Policisë, duke përfshirë dhe përdorimin e hapësirave për parkingje.

Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit dhe Nënstacioni Policor në Muçivërc luajnë një rol të rëndësishëm në garantimin e sigurisë në zonat kufitare dhe në mbrojtjen e rendit publik. Një zhvendosje e suksesshme e personelit policor në kushte të përshtatshme është e domosdoshme për vazhdimin e operacioneve të tyre pa ndërprerje, në përputhje me detyrat që kanë në mbikëqyrjen e kufirit dhe sigurinë e komunitetit.

Policia e Kosovës është e përgatitur të respektojë të gjitha kushtet që do të përcaktohen në marrëveshjen për shfrytëzimin e kësaj prone, e cila do të përgatitet pas miratimit të kësaj kërkese nga Komuna e Kamenicës. Marrëveshja do të përfshijë afatin e shfrytëzimit, kushtet e mirëmbajtjes dhe detyrimet e palëve të përfshira.

Komuna e Kamenicës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në frymën e bashkëpunimit institucional, me këtë vendim, përkrah Policinë e Kosovës në zgjidhjen e përkohshme të nevojave të tyre urgjente, duke garantuar që veprimet të jenë në përputhje me interesin publik dhe përmirësimin e kushteve të punës për personelin policor.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 31561
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 01/10 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi i Komunës**

Bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), 17, 24 dhe 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit (Nr.03/L- 040) për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 38 shkronja c) të Statutit Sh.01.Nr. 20203, të datës 21.06.2023 dhe Rregullores Komunale Sh.01.Nr.31251, të datës 29.09.2022, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, si dhe shpalljes publike me Sh.12.Nr.21532, datë 05.07.2024 dhe Vazhdimit të shpalljes publike me numër Sh.12.Nr.24187 datë 29.07.2024, për Subvencionimin e fermerëve me mekanizëm bujqësorë për minoritete, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.09.2024 miratoi këtë:

**V E N D I M**

**(Projekt : „ Furnizim i fermerëve me mekanizëm bujqësor-minoritete ”- Participimi i fermerëve)**

1. **Miratohet** vendimi për projektin me rastin e participimit me fermer dhe Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Kamenicë në shumë prej **3,447.00 €,** nën programi bujqësia **47029.**

1.1. Lejohet Participimi i fermerëve për subvencionimin e projekteve të parapara nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Kamenicë si në tabelën e bashkangjitur në këtë pikë.

| Nr. re. | Emri dhe Mbiemri | Adresa | Çmimi i mekanizmit për njësi/€. | Participimi i fermerëve në / €. | Participimi i Komunës / €. |
|---|---|---|---|---|---|
| **1. Pjatore me 24 disqe** | | | | | |
| **1** | **Zlatan Arsiç** | **Hajnoc** | **1,250.00 €.** | **375.00 €.** | **875.00 €.** |
| **2** | **Vladica Mirkoviç** | **Hajnoc** | **1,250.00 €.** | **375.00 €.** | **875.00 €.** |
| **3** | **Dobrivoje Gigiç** | **Hajnoc** | **1,250.00 €.** | **375.00 €.** | **875.00 €.** |
| **4** | **Mladjan Cvetkoviç** | **Hajnoc** | **1,250.00 €.** | **375.00 €.** | **875.00 €.** |
| **2. Kositëse bari rotative-135 cm.** | | | | | |
| **1** | **Goran Djordjeviç** | **Hajnoc** | **1,100.00 €.** | **330.00 €.** | **770.00 €.** |
| **2** | **Aleksandar Milenkoviç** | **Hodonoc** | **1,100.00 €.** | **330.00 €.** | **770.00 €.** |
| **3** | **Snezana Arsiç** | **Strelicë** | **1,100.00 €.** | **330.00 €.** | **770.00 €.** |
| **4** | **Bojan Joksimoviç** | **Boscë** | **1,100.00 €.** | **330.00 €.** | **770.00 €.** |
| **3. Shpërndarëse plehu mineral, 300L.** | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Goran Djordjeviç** | **Hajnoc** | **1,100.00 €.** | **330.00 €.** | **770.00 €.** |
| **2** | **Aleksandar Milenkoviç** | **Hodonoc** | **1,100.00 €.** | **330.00 €.** | **770.00 €.** |
| **3** | **Snezana Arsiç** | **Strelicë** | **1,100.00 €.** | **330.00 €.** | **770.00 €.** |
| **4** | **Bojan Joksimoviç** | **Boscë** | **1,100.00 €.** | **330.00 €.** | **770.00 €.** |
| **3. Shpërndarëse plehu mineral, 300L.** | | | | | |
| **1** | **Millorad Gigiç** | **Hajnoc** | **209.00 €.** | **62.70 €.** | **146.30 €.** |
| **2** | **Nevena Joviç** | **Berivojcë** | **209.00 €.** | **62.70 €.** | **146.30 €.** |
| **3** | **Goran Miljkoviç** | **Berivojcë** | **209.00 €.** | **62.70 €.** | **146.30 €.** |
| **4** | **Slavisha Andjelkoviç** | **Kamenicë** | **209.00 €.** | **62.70 €.** | **146.30 €.** |
| **5** | **Biljana Antiç** | **Kamenicë** | **209.00 €.** | **62.70 €.** | **146.30 €.** |
| **6** | **Dimitrije Jevitç** | **Meshinë** | **209.00 €.** | **62.70 €.** | **146.30 €.** |
| **7** | **Sreçko Saviç** | **Hajnoc** | **209.00 €.** | **62.70 €.** | **146.30 €.** |
| **8** | **Goran Nikoliç** | **Grizime** | **209.00 €.** | **62.70 €.** | **146.30 €.** |
| **9** | **Ljubisha Djeliç** | **Kolloleç** | **209.00 €.** | **62.70 €.** | **146.30 €.** |
| **10** | **Branislav Stojanoviç** | **Boscë** | **209.00 €.** | **62.70 €.** | **146.30 €.** |
| | | **SHUMAT TOTALE:** | | **3,447.00 €.** | **8,043.00 €.** |
| **VLERA TOTALE E PROJEKTIT: 11,490.00 €. / 2024.** | | | | | |

**2.** Participimi i fermerëve përfitues është i paraparë në Rregulloren Komunale për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve numër, Sh.01, Nr. 31251, të datës 29.09.2022 dhe shpalljes publike numër, Sh.12.Nr. 21532, datë 05.07.2024 dhe Vazhdimit të shpalljes publike me numër Sh.12, nr. 24187, datë 29.07.2024.

**3.** Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**4.** Vendimit i bashkëngjitet: Shpallja Publike, Lista e përfituesve për dorëzimin e të hollave për participim, vendimi i formimit të komisionit komunal për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve, Fletë transferi për deponim të mjeteve financiare.

**5.** Ky vendim hynë në fuqi 7 ditë pas pas publikimit në web-faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E KAMENICËS – 01 KUVENDI I KOMUNËS – REPUBLIKA KOSOVA – OPŠTINA – SKUPŠTINA OPŠTINE

**Liridon Kastrati**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
CENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Nr. Br. 01 32370
Nr. i faq. Br. str. 2
Data: Datum: 08/10
KAMENICË/A 2024

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal - Kamenicë**
**Më 08.10.2024**

Bazuar në nenet 11, 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 shkronja d), neni 24 dhe neni 40 paragrafi 40.2 shkronja c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), Ligjin Për Financat Publike dhe Përgjegjësitë Nr.05/L-007 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-048, Nenit 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03.L-049, neni 38 paragrafi 38.2 shkronja c), të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, me kërkesën Elektronike të parashtruar nga Drejtori i Arësimit të Komunës së Kamenicës të datës 27.09.2024, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.09.2024 miratoi këtë:

## VENDIM

**Për ndarjen e mjeteve buxhetore për pagesën e taksës për rritjen e kapacitetit furnizues me energji elektrike për institucionet komunale në Roganë**

1. Miratohet kërkesa e DKA-së për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 15,835.84 euro (pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë euro e tetëdhjetë e katër cent) për për pagesën e taksës për ndryshimin e trafostacionit nga 400 kW në 620 kW në Roganë, që mundëson furnizimin me energji elektrike të institucioneve komunale.

2. Vendimi si në pikën 1 miratohet me kërkesën e parashtruar nga Drejtoria Komunale e Arsimit.

3. Mjetet ndahen nga kodi buxhetor i DKA-së, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi obligohen drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria Komunale e Arësimit dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.

5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

*Vendim t'i dërgohet*: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrtarit për Përkthime, Drejtorisë Komunale të Arësimit, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe Arkivit, MAPL-së dhe QSHQ - Arkivit.

**Liridon Kastrati**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

### *A r s y e t i m*

Propozim vendimi për aprovimin e buxhetit për pagesën e taksës për rritjen e kapacitetit furnizues me energji elektrike për SHFMU "Metush Krasniqi" dhe institucionet e tjera komunale në Roganë bazohet në nevojën për përmirësimin e infrastrukturës energjetike, që është e domosdoshme për funksionimin e qëndrueshëm të sistemeve të ngrohjes dhe shërbimeve të tjera të rëndësishme.

Gjatë renovimit të brendshëm të SHFMU "Metush Krasniqi", është instaluar një sistem i ri i ngrohjes me pompa termike, që kërkon shtimin e kapacitetit furnizues me energji elektrike për të funksionuar siç duhet. Kërkesa e bërë ndaj KEDS ka treguar se trafostacioni aktual nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për të përballuar këtë ngarkesë, çka mund të rezultojë në probleme serioze me furnizimin me energji elektrike për shkollën dhe institucionet e tjera komunale si Qendra e Mjekësisë Familjare dhe çerdhja e planifikuar në të njëjtën zonë.

Pas diskutimeve me KEDS, është arritur marrëveshja që trafostacioni do të rritet nga 400 kW në 620 kW, duke plotësuar kështu nevojat për furnizim stabil dhe të qëndrueshëm me energji elektrike. Megjithatë, për të realizuar këtë përmirësim, Komuna e Kamenicës duhet të paguajë një taksë prej 15,800.00 euro.

Ky investim është thelbësor për të siguruar funksionimin e pandërprerë të institucioneve komunale, duke përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme cilësinë e shërbimeve për qytetarët e kësaj zone, përfshirë shërbimet arsimore dhe shëndetësore. Për më tepër, ky kapacitet i shtuar do të mbështesë edhe ndërtimin e çerdhes, për të cilën tashmë ekziston një memorandum bashkëpunimi me MASHTI dhe është në proces zbatimi përmes procedurave të prokurimit.

Me këtë vendim, Komuna e Kamenicës do të siguroj se të gjitha institucionet komunale të përfshira kanë kapacitetin e nevojshëm për zhvillimin e funksioneve të tyre.

REPUBLIKA E KOSOVËS
[illegible]PUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. 01 Nr. 32895
Br.
Fq. 2 Data: 11.10
Br. str. Datum:
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal - Kamenicë**
**Më 10.10.2024**

Në bazë të nenit 13 dhe 14 paragrafi 14.1 të Ligjit nr 03/L-040, Për Vetëqeverisje Loklale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/12, qershor 2008), neni 28 dhe 46 të Ligjit Nr. 04/L-060 Për Mbeturina, neni 8 të Udhëzimit Administrativ (Qrk) Nr.06/2016 Mbi Kushtet Për Zgjedhjen e Lokacionit dhe Ndërtimin e Deponisë së Mbeturinave, neni 7 Udhëzimit Administrativ (Qrk) Nr.08/2017 Për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave, Kërkesës Sh.02.Nr.31335 e datës 30.09.2024 të parashtruar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, në mbështetje të nenit 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.09.2024 miratoi këtë:

## VENDIM

### Caktimi i lokacionit në pronën e paluajtshme të Komunës së Kamenicës për ndërtimin e Objektit për Menaxhimin Qarkor të Mbeturinave Organike

1. Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektit për Menaxhimin Qarkor të Mbeturinave Organike në Zonën Kadastrale në Kopërnicë.

2. Lokacioni si në pikën 1 të këtij vendimi caktohet në ngastrën P-71107039-00778-0 në sipërfaqe prej 21855 $m^2$ pronë shoqërore e Komuna e Kamenicës, vendi i quajtur Rupina.

3. Lokacioni caktohet duke u mbështetur në Kërkesën Sh.02.Nr.31335 e datës 30.09.2024 të parashtruar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektoratit dhe Emergjenca.

4. Kompetent për ekzekutimin e këtij vendimi është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektoratit dhe Emergjenca në koordinim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorinë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse.

6. Vendimit i bashkangjitet; Kërkesa Sh.02.Nr.31335 e dates 30.09.2024 të parashtruar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektoratit dhe Emergjenca, Ekstrakti Sh.01.Nr.31381 i datës 30.09.2024 nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Certifikata e Njësisë Kadastrale me nr të lëndës 2202/2024 e datës

30.09.2024, Kopja e Planit e datës 30.09.2024.

7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Shërbimit të Kuvendit;***
- ***Zyra e Informimit;***
- ***Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;***
- ***Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;***
- ***Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;***
- ***Drejtorinë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat; dhe***
- ***Arkivit.***

**Liridon Kastrati**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 36978
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 27/11 2024
KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal - Kamenicë**
**Më 27.11.2024**

Në bazë të nenit 13 dhe 14 paragrafi 14.1 të Ligjit nr 03/L-040, Për Vetëqeverisje Loklale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/12, qershor 2008), neni 23 paragrafi 3 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-060 Për Mbeturina i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-071, neni 7 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.20/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave Biodegraduese, Kërkesës Sh.02.Nr.31335 e datës 30.09.2024 të parashtruar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, në mbështetje të nenit 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 27.11.2024 miratoi këtë:

# V E N D I M

## Caktimi i lokacionit në pronën e paluajtshme të Komunës së Kamenicës për ndërtimin e Objektit për Menaxhimin Qarkor të Mbeturinave Organike

1. Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektit për Menaxhimin Qarkor të Mbeturinave Organike në Zonën Kadastrale në Kopërnicë.

2. Lokacioni si në pikën 1 të këtij vendimi caktohet në ngastrën P-71107039-00778-0 në sipërfaqe prej 21855 $m^2$ pronë shoqërore e Komuna e Kamenicës, vendi i quajtur Rupina.

3. Lokacioni caktohet duke u mbështetur në Kërkesën Sh.02.Nr.31335 e datës 30.09.2024 të parashtruar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektoratit dhe Emergjenca.

4. Kompetent për ekzekutimin e këtij vendimi është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektoratit dhe Emergjenca në koordinim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorinë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse.

6. Vendimit i bashkangjitet; Kërkesa Sh.02.Nr.31335 e dates 30.09.2024 të parashtruar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektoratit dhe Emergjenca, Ekstrakti Sh.01.Nr.31381 i datës 30.09.2024 nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Certifikata e Njësisë Kadastrale me nr të lëndës 2202/2024 e datës 30.09.2024, Kopja e Planit e datës 30.09.2024.

*Vendimi i`u dërgohet:*

- *Zyrës së Kryetarit;*
- *Shërbimit të Kuvendit;*
- *Zyra e Informimit;*
- *Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;*
- *Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;*
- *Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;*
- *Drejtorinë për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat; dhe*
- *Arkivit.*

**Liridon Kastrati**

______________________________

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 36973
Nr. i faq. Br. str. 3 Data Datum: 27/11 2024
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 27.11.2024**

Në bazë të nenit 11, 12, paragrafi 12.2 pika (d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit Nr 03/L-040, Për Vetëqeverisje Loklale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/12, qershor 2008) neni 21 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës lidhur me nenin 24 dhe 25 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, Kërkesës 01/0917 të datës 27.09.2024 e parashtruar nga MPB Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, neni 3 paragrafi 3.7 neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit 01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 27.11.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

## Për dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës për Policinë e Republikës së Kosovës

1. Me këtë Vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Kamenicës, në bazë të Kërkesës së parashtruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, kërkesës 01/0917 të datës 27.09.2024 e parashtruar nga MPB Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, pa procedurë të rregullt të Konkurrimit bazuar në ligjet ne fuqi.

2. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, ish Objekti i Nënstacionit të Zjarrëfikësve dhe Shpëtimit duke përfshirë edhe parkingjet në fshatin Muçivërc, dhe i ka këto karakteristika parcela me numër të ngastrës katastrale P-711107055-01154-1 me sipërfaqe prej 820 m², P.SH. Kuvendi Komunal Kamenicë.

3. Qëllimi i dhënjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin (2) të këtij vendimi është shfrytëzimi i ish Objekti i Nënstacionit të Zjarrëfikësve dhe Shpëtimit duke përfshirë edhe parkingjet në fshatin Muçivërc, pasi që gjendja e objektit të SPMK Muçivërc është shumë në gjendje të keqe për shkak të vjetërsisë së objektit fakt ky i konstatuar edhe nga ana e Inspektorëve Sanitarë, dhe ish Objekti i Nënstacionit të Zjarrëfikësve dhe Shpëtimit në fshatin Muçivërc është në gjendje të mirë dhe më i përshtatshëm për Policinë e Republikës së Kosovës SPMK Muçivrcë.

4. Afati kohor për dhënje në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të përshkruar në nenin (2) të këtij vendimi jepet në shfrytëzim prej tre (3) vitesh, me mundesi vazhdimi.

5. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në nenin (2) të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim. Me qëllim të rikthimit të objektit Komunal në shfryrtëzim për Policinë e Republikës së Kosovës.

6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse.

7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.82 të dt. 03.06.2010 i Kuvendit të Komunës.

8. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Shërbimit të Kuvendit;***
- ***Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;***
- ***Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor; dhe***
- ***MAPL-së;***
- ***Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë; dhe Arkivit.***

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

**Arsyetim**

Komuna e Kamenicës, duke marrë në konsideratë kërkesën e drejtuar nga Policia e Kosovës për shfrytëzimin e përkohshëm të ish-objektit të Nënstacionit të zjarrfikësve dhe shpëtimit në fshatin Muçivërc, bazuar në ligjet dhe rregullat në fuqi, propozon dhënien e këtij objekti për një periudhë prej tri (3) viteve, me mundësi vazhdimi.

Sipas kërkesës së Policisë së Kosovës, objekti aktual i Nënstacionit Policor në Muçivërc nuk përmbush kushtet për funksionim dhe është në gjendje të papërshtatshme për personelin policor. Objekti është i vjetër dhe qëndrimi i mëtejshëm rrezikon shëndetin dhe mirëqenien e stafit. Demolimi i këtij objekti dhe ndërtimi i një të riu është i domosdoshëm, por për një zgjidhje të përkohshme kërkohet zhvendosja e personelit në një objekt që i plotëson kushtet minimale të funksionimit.

Ish-objekti i Nënstacionit të zjarrfikësve dhe shpëtimit, sipas vlerësimit të Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve të Policisë së Kosovës, i plotëson kushtet teknike për strehimin dhe funksionimin e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit dhe Nënstacionit Policor në Muçivërc. Ky objekt do të përshtatet për nevojat e përkohshme të Policisë, duke përfshirë dhe përdorimin e hapësirave për parkingje.

Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit dhe Nënstacioni Policor në Muçivërc luajnë një rol të rëndësishëm në garantimin e sigurisë në zonat kufitare dhe në mbrojtjen e rendit publik. Një zhvendosje e suksesshme e personelit policor në kushte të përshtatshme është e domosdoshme për vazhdimin e operacioneve të tyre pa ndërprerje, në përputhje me detyrat që kanë në mbikëqyrjen e kufirit dhe sigurinë e komunitetit.

Policia e Kosovës është e përgatitur të respektojë të gjitha kushtet që do të përcaktohen në marrëveshjen për shfrytëzimin e kësaj prone, e cila do të përgatitet pas miratimit të kësaj kërkese nga Komuna e Kamenicës. Marrëveshja do të përfshijë afatin e shfrytëzimit, kushtet e mirëmbajtjes dhe detyrimet e palëve të përfshira.

Komuna e Kamenicës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në frymën e bashkëpunimit institucional, me këtë vendim, përkrah Policinë e Kosovës në zgjidhjen e përkohshme të nevojave të tyre urgjente, duke garantuar që veprimet të jenë në përputhje me interesin publik dhe përmirësimin e kushteve të punës për personelin policor.

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 37820
Nr. i faq. Br. str. 2 Data Datum: 09/12 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal Kamenicë**
**Më:09.12.2024.**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), neni 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe neni 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 3, neni 8 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, dhe neni 3 paragrafi 3.7, nenit 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 paragrafi 38.1 dhe neni 86 të Statutit Sh.01.Nr.20203 datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 27.11.2024 miratoi këtë:

## V E N D I M
## PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE PËRMES ANKANDIT PUBLIK

1. Me këtë Vendim, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtëshme të Komunës së Kamenicës, në shfrytëzim afatshkurtër përsonave fizik dhe juridik si në vijim:

   **1.1.** Njësia kadastrale me nr. P-71107063-00292-0, vendi i quajtur, Kodra e Makovishte me sipërfaqe prej 82696 $m^2$, në zonën kadastrale në Poliçkë, Komuna e Kamenicës.

   **1.2.** Njësia kadastrale me nr. P-71107063-00342-0, vendi i quajtur, Kodra e Makovishte me sipërfaqe prej 47993 $m^2$, në zonën kadastrale në Poliçkë, Komuna e Kamenicës.

2. Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme Komunale është afatshkurtër me kohëzgjatje prej 15 viteve me destimin kultivimi i kulturave bujqësore me qëllim të shfrytëzimit nga ana e personave fizik apo juridik.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe blegtorisë si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.

4. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.

5. Procedurat për dhënien e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Kembim të Prones së Palujtshme të Komunës.

6. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshëme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfitusit të marrjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme në periudhë afatshkurtër të shfrytëzimit me të drejtë të shkëputjes së kontratës edhe para afatit nëse prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllime të cekura në nenin 2 të këtij vendimi.

7. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë përkatëse.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi ***Shfuqizohet*** Vendimi Sh.01.Nr.14960 i datës 10.05.2024 për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale Përmes Ankandit Publik.

9. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet****: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Shërbimit të Kuvendit, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-së dhe QSHQ- arkivit.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY...
CENTAR ZA USLUGU GRA...
Sh. U. 01 Nr. Br. 37827
Nr. i faq. Br. str. 1 Data Datum: 09/12 2024
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal - Kamenicë**
**Më 09.12.2024**

Në bazë të nenit 11,12, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 shkronja d, neni 14.1, neni 17 pika c), dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, ( " Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës " nr.28/2008 ), nenit 27 (E drejta e komunës për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga institucionet qendrore) të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës se Paluajtshme të Komunës, nenit 34 dhe 35 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 4, paragrafit 1, pika 1.1 dhe paragrafi 2, pika 2.3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Ligji nr.03/L-139, si dhe nenit 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h),, neni 38 si dhe nenit 38.1 të Statutit Sh.02.nr.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 27.11.2024 miratoi këtë :

**V E N D I M**

**Për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme, të cilat janë nën menaxhim të AKP-së, P.SH Ekonomia e Pyjeve, , P.SH Koperativa Bujqesore Vllaznim Bashkimi,**

1. Vendimi për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme, të cilat janë nën menaxhim të AKP-së, P.SH Ekonomia e Pyjeve zona kadastrale Moçar vendi i quajtur "Perin Zabelj", P.SH Koperativa Bujqesore "Vllaznim Bashkimi" në zonat Kadastrale në Kolloleç vendi i quajtur "Dugi Deo", si në vijim:

   - P- 71107054-00305-0, Moçar me sipërfaqe prej 19745 $m^2$.
   - P- 71107038-02841-0, Kolloleç, me sipërfaqe 75593 $m^2$

2. Shpallja me Interes të Përgjithshëm Publik ka për qëllim bartjen e këtyre pronave në emër të Komunës së Kamenicës, për realizimin e deponive inerte.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Kryetari i Komunës inicon tek organet kompetente : Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Agjencioni Kosovar i Privatizimit, procedurat e parapara ligjore për kthimin e këtyre pronave Komunës së Kamenicë për realizimin e interesit të përgjithshëm publik, për zbatimin e Vendimit do të kujdesen Kryetari i Komunes, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që konfrom dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-

092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës të vazhdojnë me procedurat për bartjen e këtyre pronave në emër të Komunës.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kopja e Planit dhe Çertifikatat e njësive kadastrale.

5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i'u dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, MAPL-së, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe QSHQ- arkivi.*

**Liridon Kastrati**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE / CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 37828
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 09/12 2024
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal - Kamenicë**
**Më 09.12.2024**

Në bazë të nenit 11,12, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 shkronja d, neni 14.1, neni 17 pika c), dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, ( " Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës " nr.28/2008 ), nenit 27 (E drejta e komunës për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga institucionet qendrore) të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës se Paluajtshme të Komunës, nenit 34 dhe 35 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 4, paragrafit 1, pika 1.1 dhe paragrafi 2, pika 2.3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Ligji nr.03/L-139, si dhe nenit 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h),, neni 38 si dhe nenit 38.1 të Statutit Sh.02.nr.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 27.11.2024 miratoi këtë :

# VENDIM

## Për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të pronës të paluajtshme, e cila është nën menaxhim të AKP-së, P.SH Ujrat,

1. Vendimi për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të pronës të paluajtshme, e cila është nën menaxhim të AKP-së, P.SH Ujrat, zona kadastrale Grizimë vendi i quajtur "Bare", si në vijim:

    - P-71107023-01359-0,Grizime me sipërfaqe prej 37074 m²,

2. Shpallja me Interes të Përgjithshëm Publik ka për qëllim bartjen e kësaj prone në emër të Komunës së Kamenicës, për shfrytëzimin e pusit për Parcelen: P-71107023-01359-0.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Kryetari i Komunës inicon tek organet kompetente : Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Agjencioni Kosovar i Privatizimit, procedurat e parapara ligjore për kthimin e këtyre pronave Komunës së Kamenicë për realizimin e interesit të përgjithshëm publik, për zbatimin e Vendimit do të kujdesen: Kryetari i Komunes, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që konfrom dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës të vazhdojnë me procedurat për bartjen e këtyre pronave në emër të Komunës.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kopja e Planit dhe Çertifikatat e njësive kadastrale.

5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i'u dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, MAPL-së, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe QSHQ- arkivi.*

**Liridon Kastrati**

______________________

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TE QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 10954
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 05/04
KAMENICË/A 2024

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 05.04.2024**

Në bazë të nenit 12, të Ligjit nr 03/L-040, Për Vetëqeverisje Loklale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/12, qershor 2008), nenit 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, nenit 53 paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithëshme Administrative, neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit 01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 05.04.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Bazë Sh.01.Nr.3966 për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale – Lokal ish "Shtëpia e Vjetër e Komunës"**

1. **NDRYSHOHET** dhe **PLOTËSOHET** pika **1** dhe pika **3** e Vendimit bazë Sh.01.Nr.3966 i datës 05.02.2024 për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale – Lokal ish "Shtëpia e Vjetër e Komunës".

2. Korigjohet Pika 1 e Vendimit Bazë Sh.01.Nr.3966 i dates 05.02.2024, për pronën e paluajtshne të Komunës së Kamenicës me numër kadastral P-71107041-01553-0-22-0 përkatësisht sa i përket sipërfaqes së objektit me nr të parcelës O-071107041-22-1-1-0, prej sipërfaqes 2002 korrigjohet në sipërfaqen 200$m^2$ si dhe parcela me nr O-071107041-22-1-4-0, prej sipërfaqes 2002 korrigjohet në sipërfaqen 200$m^2$.

3. Fshihet Pika 3 e Vendimit Sh.02.Nr.3966 i datës 05.02.2024 dhe zëvendësohet me tekstin: Procedurat për dhënien e pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzim afatshkurtër të realizohet përmes ankandit publik, në harmoni me ligjin Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajteshme të Komunës.

4. Ky Vendim është pjesë përbërse e Vendimit Sh.02.Nr.3966 i datës 05.02.2024 për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale – Lokal ish "Shtëpia e Vjetër e Komunës".

5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Zyrës së Informimit;***
- ***MAPL-së; dhe***
- ***Arkivit.***

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Liridon Kastrati**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Nr. 01 Nr. Br. 14946
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 10/05
KAMENICË/A 2024

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtëshme dhe të nenin 12, paragrafi 2 shkronja (d) në lidhje me nenet 14 paragrafi 1 dhe 17 shkronja (c) si dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenit 27 (me theks paragrafët 1 dhe 2) të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënin e Shfrytëzim dhe Kembimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ndërlidhur me nenet 34 dhe 35 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytezim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 07.05.2024 miratoi këtë;

## VENDIM
## PËR SHPALLJEN NË INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK

1. Miratohet Vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik prona e paluajtshme e cila është nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si në vijim:

    1.1. Pronat e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 40503 m$^2$, sipas certifikatës pronesore P-71107003-00580-0 të datës 02.05.2024, në Zonën Kadastrale Berivojcë, të evidentuara si Pronë Shoqërore në Pronësi të NEWCO XIM STREZOC MAGNESITE MINEL.L.C, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovare e Privatizimit. Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm publik të kësaj prone është për realizimin e projektit ndërtimin e fabrikës për Prodhimin e Energjisë Elektrike dhe të Ngrohjes "PRAPASHTICA BIOGAS ENERGY" SH.P.K."

2. Autorizohet Kryetari i Komunës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

3. Për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore lidhur me rregullimin e dokumentacionit teknik, regjistrimin e pronës në librin kadastral si dhe çështje e veprime tjera të nevojshme obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

4. Per zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

5. Parcela e cekur në pikën **1.1** të këtij vendimi të bartet në pronësi të Kuvendit Komunal të Kamenicës

6. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS * OPŠTINA KAMENICA
01 KUVENDI I KOMUNËS * SKUPŠTINA OPŠTINE

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 21673
Nr. i fag. 2 Data: Datum: 08/07 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 08.07.2024**

Bazuar në nenet 12 dhe 14 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenin 11 të për dhëniene në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Qarkorën Ligjore për procedurën e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim , sipas nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhëniene në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 23 i Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nxjerr nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 10.08.2020, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës dhe kërkesës nga MAPL-ja nr.020-194/8, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e Jashtëzakonshme të mbajtur me datë 08.07.2024 miratoi këtë:

**VENDIM**

**Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për " Hydeajet Pireva B.I " , me procedurë të negocimit të ofertës**

1. Me këtë vendim "Hydajet Pireva B.I" - (Certifikata e Regjistrimit: 812093615) , me përfaqësues Hydajet Pireva nga Kamenica, **i IPET** në shfrytëzim afatgjatë prej njëzetë (20) vitesh, prona e paluajtshme e Komunës, sipas procedurës së negocimit.

2. Prona e paluajtshme e Komunës e dhënë në shfrytëzim sipas pikës (1) një të këtij vendimi, është në sipërfaqe prej 70000m$^2$, Parcela Kadastrale P-71107041-01075-5 e cila gjendet në Z.K pronë shoqërore Komuna e Kamenicës.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale është realizimi i projektit **" Ngritja e Plantacionit me Arrë "** ashtu siç është përcaktuar në ofertën e negociuar. Investimi total duhet të arrij 212,590.00 €, me rastin e funksionalizimit të projektit do të angazhoj plus katër (4) punëtorë nuk guxon të bijë më poshtë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik pa koordinim dhe pajtim me Komunën e Kamenicës, prej momentit që "Hydajet Pireva B.I", fillon me kapacitet të plotë.

4. "Hydajet Pireva B.I" në emër të kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale do t'i paguaj Komunës qira vjetore në vlerë prej 1% të qarkullimit vjetor nga Subjekti "Hydajet Pireva B.I", por jo më pak se çmimi i qirasë së tokës i përcaktuar me rregullore Komunale (EUR/vit).

5. Dhënia e pronës së paluajtshme komunale, edhe në këto raste evidentohet, në regjistrin e të drejtave pronësore.

6. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen, me kontratë të veçantë në mes të kryetarit të komunës dhe Kompanisë "Hydajet Pireva B.I", e cila hartohet dhe nënshkruhet nga palet pas miratimit të Propozimi vendimit të Kryetarit në Kuvend dhe pas aprovimit të ligjshmërisë së vendimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku pjesë përbërse do të jetë edhe Oferta e negociuar, plani i biznesit, plani dinamik dhe projekti ideor, ndërkaq pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet komunës.

7. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës, DPGJK-ja, dhe DUPH-ja.

8. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Qeverisje Lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- ***Zyrës së Kryetarit;***
- ***Zyrës së Informimit;***
- ***Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;***
- ***Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;***
- ***MAPL-së; dhe***
- ***Arikivit***

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 32660
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 10.10 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal - Kamenicë**
**Më 10.10.2024**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja d), nenin 24 dhe nenin 40, paragrafi 2, shkronja b), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/12, qershor 2008); nenit 46, shkronja b), si dhe Udhëzimeve mbi përpilimin dhe miratimin e Buxhetit Komunal, neni 61 i Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe neni 38 paragrafi 38.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të dates 21.06.2023 të Komunës se Kamenicës, dhe draft-buxhetit Sh.05.Nr.27962 i datës 30.08.2024, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 09.10.2024 miratoi këtë:

# V E N D I M

## Për miratimin e Buxhetit Komunal për vitin 2025 dhe parashikimin për vitet 2026-2027

Buxheti Komunal për vitin 2025 planifikohet në bazë të obligimeve dhe detyrave që dalin nga Statuti i Komunës së Kamenicës dhe është i bazuar në realizimin e buxhetit komunal për vitin 2023, buxhetit të Komunave të Kosovës për vitin 2025 të përcaktuar nga komisioni i Granteve Qeveritare dhe të miratuar nga Ministria për Financa, në mbështetje të Qarkores buxhetore 2025/01, Qarkores buxhetore 2025/02, buxhetimit programor si dhe Kornizës Afatmesme buxhetore 2025-2027 për të hyrat dhe shpenzimet, për programet buxhetore sipas kategorive ekonomike dhe atë nga Granti Qeveritar dhe nga të hyrat vetanake.

1. **Buxheti komunal sipas fondeve burimore për vitin 2025 është prej 15,282,624.00 €**

**1.1 Granti Qeveritar** 14,148,552.00 €

**1.1.1** Granti i përgjithshëm 6,452,896.00 €
**1.1.2** Granti Specifik për Arsim 5,433,969.00 €
**1.1.3** Granti Specifik për Shëndetësi ,2,041,687.00 €
**1.1.4** Grandi i Shërbimeve Sociale Rezidenciale 220,000.00 €

**1.2 Të Hyrat Vetanake 1,134,072.00 €**

**1.3 Buxheti komunal sipas kategorive ekonomike për vitin 2025 është prej 15,282,624.00 €**

**1.3.1** Paga dhe meditje. 9,185,435.00 €
**1.3.2** Mallra dhe shërbime 2,422,098.00 €
**1.3.3** Shpenzime komunale 262,000.00€
**1.3.4** Subvencione dhe Transfere 885,000.00 €
**1.3.5** Investime kapitale 2,528,091.00 €

2. Pjesë përbërse e këtij vendimi është plani i buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimi për vitet 2026-2027/Tabela 4.1, 4.2 ,4.3 dhe tabelat e buxhetimit të Përgjegjëshëm Gjinor 2022-2025.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Kamenicë, ky vendim hyn në fuqi 7, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008"), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi t'i dorëzohet:*** *Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Kuvendit Komunal, DFB-së, Zyrës së përkthimeve, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

**Liridon Kastrati**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 32876
Nr. Faq. Br. str. 2 Data: Datum: 11/10
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal - Kamenicë**
**Më 11.10.2024**
Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) si dhe nenit 40,paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L 049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me ligjin Nr. 05/L-007, nenit 16 paragrafi 8 pika 8.2 të Ligjit Nr. 08/L-260 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 dhe nenit 38 paragrafi 38.1 shkronja c) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 09.10.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

**Për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin "Asfaltimi i rrugëve në Karaçevë të Epërme" në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit të Shoqatës "Firishta" nga Karaçeva e Epërme**

1. Miratohet Vendimi për krijimin e kodit të ri për projektet kapitale nga kodi i bashkëfinancimit me rastin e participimit me komunitetin/donatorëve në shumë totale të projektit prej 55,835.65 Euro sipas nenit 16 paragrafi 8 nënparagrafi 8.2. të Ligjit për Buxhet për vitin 2024 për projektin "Asfaltimi i rrugëve në Karaçevë të Epërme", në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit të Shoqatës "Firishta" nga Karaçevë e Epërme.

2. Krijimi i kodit të ri është i paraparë në nenin 16 paragrafi 8 nëparagrafi 8.2 të Ligjit për Buxhet për vitin 2024 Ndryshimet e shumta të ndara për projektet kapitale në kuadër të nënprogramit, Zyra e Kryetarit 16029, projekti '' Participimi me Donator'' kodi i projektit 52633.

| Nr. | Emri i Projektit | Vendi | Shuma totale e projektit | Shuma për participim/komuniteti/ | Shuma për participim/komuna/ |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | "Asfaltimi i rrugëve në Karaçevë të Epërme" | Karaçevë e Epërme | 55,479.50 € | 16,643.65 € | 38,835.65 € |

3. Në kuadër të projektit të lartëcekur, Komuna e Kamenicës dhe Shoqata "Firishta" do të participojnë më kontribut financiar në shumën 55,479.50 € (pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë euro e pesëdhjetë cent), (Komuna e Kamenicës me shumën prej 38,835.65 € (tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë euro e gjashtëdhjetë e pesë cent) që do të participohen nga Buxheti Komunal Kamenicë dhe Shoqata "Firishta" me shumën prej 16,643.85 € (gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre euro e tetëdhjetë e pesë cent).

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Financa dhe Buxhet të Komunës së Kamenicës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përkatëse për qeverisje lokale si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Kuvendit, Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, MAPL-së dhe Arkivit.

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 32878
Nr. i faq. Br. str. 3 Data: Datum: 11/10
KAMENICË/A 2024

**Kuvendi Komunal - Kamenicë**
**Më 11.10.2024**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2,pika (d), lidhur me nenin 17 shkronja (b), nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008);/Nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, pika 1.2.1, nenit 10, paragrafi 1, nenit 11 paragrafi 1, pika 1.12, dhe nenit 20 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, datës 31.07.2013, e konformë Nenit 3 , paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, nenit 4 , paragrafi 3, pika 3.1 , nenit 6, nenit 8. nenit 10, nenit 11, nenit 12, dhe neni 14 të Administrativ MMPH Nr.05/ 2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Statutit të Komunës së Kamenicës Vendimi Sh.01,nr.20203 dt.:21.06.2023,Kuvendi Komunal në Kamenicë në mbledhjen e jashtëzakonshme e mbajtur më:09.10 2024 miraton këtë:

# V E N D I M

## Për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt - Planit Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2024 -2032

### Neni 1

**Miratohet Vendimi** për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt - Planit Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2024 -2032.

### Neni 2

**Qëllimi i paraqitjes së këtij Propozim Vendimi për hapjen e** shqyrtimit publik i Projekt - Plani Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2024 -2032, të cekur si në nenin 1 të këtij Propozim Vendimi, është që dokumenti të jetë i hapur për publikun ku ftohen, qytetaret , ekspertët dhe palët e interesit për të parashtruar komentet apo sygjerimet para finalizimit të dokumentit të planifikimit hapsinor - Draft dokumentit Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Kamenicës.Autoriteti i planifikimit përkatësisht Komuna e Kamenicës siguron dhe inkurajon pjesëmarjen publike transparente në procesin e planifikimit duke ofruar qasje publike në çdo fushtë të zhvillimit hapsinor në tërë teritorin e komunes të planifikuar në këtë dokument.

2.1. Ekspozimi i Projekt - Planit Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2024 -2032, parashihet të bëhet në sallën e Kuvendit Komunal, tetë (8) dite pas publikimit te vendimit ne webfaqen e komunes.

2.2. Për të promovuar gjithë përfshirjen dhe transparencën parashihet të mbahet një prezantim ne objektin e shtepise se kultures ne diten e pare te periudhes se shqyrtimit publik, gjegjesisht tetë (8) dite pas publikimit te vendimit ne webfaqen e komunes.

2.3. Gjatë periudhes se shqyrtimit publik mbahet procesverbali, per kerkesat me shkrim dhe propozimet verbale nga pjesemaresit dhe palet e interesit.

2.4. Shqyrtimi publik i Projekt - Planit Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2024 -2032do të zgjasë 30 ( tridhjetë ) ditë sipas procedurave te percaktruara me ligj.

2.5. Njoftimi publik për Projekt - Planin Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2024 -2032, bëhet së paku 8 ( tetë ) ditë para hapjës së shqyrtimit publik, përmes mjeteve të informimit publik, Web-faqën zyrtare të Komunës dhe në mediat publike lokale.

**Neni 3**

3.1. Në shqyrtim publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projekt - Plani Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2024 -2032:.

3.2. Në shqyrtim publik prezantohen fazat e Projekt - Plani Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2024 -2032: **Korniza Strategjike, Vlerësimi i Gjendjes, Vizioni, qëllimet dhe objektivat , Koncepti Hapësinior, Plani i Veprimit , duke përfshirë të gjitha anekset**.

3.3. Projekt - Plani Zhvillimor i Komunës së Kamenicës 2024 -2032, do të jetë i qasshëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

**Neni 4**

4.1. Ky projekt-dokument do t'i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sygjerimeve të publikut para se të finalizohet.

4.2. Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sygjerimet që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adreses elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

**Neni 5**

Shqyrtimit publik të Projekt - Plani Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2024 -2032, organizohet nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapesinor e Komunes se Kamenices në suaza të kompetencave me ligj.

**Neni 6**

6.1. Me kete vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik.

6.2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik.

**Neni 7**

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në pajtim me dispozitat ligjire të Ligjit Nr. 04/ L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.05/ 2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit hapësinor, si

dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor do të bëjë hapja e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor - Plani Zhvillimor Komunal e Komunës së Kamenicës.

**Neni 8**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor në Komunën e Kamenicës.

**Neni 9**

Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjete (15) ditë pas regjistrimit në zyrën protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal MAPL-ë, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

**Vendimi i dërgohet :** Kryetarit të Komunës , MAPL-së, DUPH-së, Shërbimit profesional të Kuvendit , zyrës për përkthime dhe QShQ-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS 01 KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE OPŠTINA KAMENICA

**Liridon Kastrati**

__________________________

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

**A R S Y E T I M**

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor në Komunën e Kamenicës, pas pranimit të vendimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vendimit SP-02 nr. 4633-2/24 të datës 27.09.2024 "Vendim për pëlqim për hapje të shqyrtimit publik, të projekt Planit Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2024-2032", i ka propozuar zyrës ligjore të Kuvendit të Komunës së Kamenicës propozim vendimin për Hapjen e shqyrtimit publik për projekt Planin Zhvillimor të Komunës së Kamenices 2024-2032.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 32662
Nr. i faq. 3 Data: Datum: 10.10
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal - Kamenicë**
**Më 10.10.2024**

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, 24 dhe neni 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, neni 15,16 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, neni 30 i ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë, dispozitave të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr.05.L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe Kërkesës Sh.02.Nr.31553 i datës 01.10.2024 për Transfer dhe Rialokim e parashtruar nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, neni 38 paragrafi 38.1 shkronja c) i Statutit Sh.02.20203 të datës 21.06.2023, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 09.10.2024 miratoi këtë:

## VENDIM
## Për transfer dhe rialokim të mjeteve

1. Miratohet vendimi për transfer dhe rialokim të mjeteve nga shpenzimeve kapitale për vitin 2024.

2. Mjetet për transfer dhe rialokim sipas pikës 1 të këtij vendimi janë si vijon:

3. Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 10 nënprogrami Planifikimi Urban dhe Inspekcioni /66450/ shuma prej 481,921.44 €.

- **<u>Nga Projektet:</u>**

  - Asfaltimi I rrugeve ne fshatin Busavat rr Tema ,rr Rama,Hasani,Hyda,Shahin Bejta Mehmet Rama degz,kodi I projektit 55067, shuma prej 49,841.80
  - Asfaltimi I rrugeve ne Hogosht ,kodi I projektit 54829,shuma prej 69,175.40€
  - Asfaltimi I rrugeve lokale ne Karaqeve e EP,kodi I projektit 54845,shuma prej 49,506.50€
  - Asfaltimi I rrugeve lokale ne Karaqeve e Ulet,kodi I projektit 54847,shuma prej 39,850.00€
  - Asfaltimi I rrugeve ne Dajkoc,rr Shaban Syle Krasniqi,Nebiu,Ali Zylfi Fazliu,Syle Rama,Dajkoc,Xhafer e Nevzad Krasniqi ,kodi I projektit 53441,shuma 39,822.09€
  - Asfaltimi I rrugeve ne Berivojcë,kodi I projektit 54875,shuma prej 29,775.26€
  - Asfaltim I rrugeve lokale ne Petrit ,kodi I projekti 54880,shuma prej 29,792.34€
  - Asfaltimi I rrugeve ne Shipashnice te EP,kodi I projektit 54883,shuma prej 59,242.50€
  - Asfaltimi I rrugeve ne Ruboc Hasan Prishtina ,kodi I projektit 54887,shuma prej 19,941.55€

- Ndertimi dhe hapja e rrugeve ne Muqiverc,Koretin,Malesine e Kamenices Kodi I projektit 54891,shuma prej 76,774.00€
- Asfaltimi I rrugeve ne Shipashnice e Ulet,rr Pishat,rr Kranidell dhe rr Bahri Fazliu,kodi I projektit 52880,shuma 18,200.00

- **Në Projektet ekzistues :**

- Asfaltimi I rrugeve ne Kamenice(Ali Hadri,Dardaneve,Nuhi Berisha,Nexhemedin Kuqi,Shpend Dragobia,Sahit Baliq,Lam Breznica,deg Shpend Dragobia,deg Besnik Maroca,Beteja e Ushit,Sef Koshara,kodi I projektit 54824,shuma prej 165,234.19€
- Asfaltimi I rrugeve lokale ne Topanice ,kodi I projektit 54830,shuma prej 71,446.72€
- Asfaltimi I rrugeve ne Koretin ,kodi I projektit 54835,shuma prej 163,828.95€
- Asfaltimi I rrugeve ne Kopernice ,kodi I projektit 54842,shuma e projektit 22,594.21€
- Asfaltimi I rrugeve ne Muciverc,kodi I projektit 54856,shuma prej 39,703.52€
- Asfaltimi I rrugeve ne Rogane kodi I projektit 54874,shuma prej 19,113.91€

4. **<u>Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 10 nënprogrami Administrata /16329/ shuma prej</u> 25,000.00 €.**

- **<u>Nga Projektet:</u>**

- Dixhitalizimi i arkivit komunal ne Komunen e Kamenicës kodi i projektit 55070,shuma 20.000.00 €.

- Ndertimi i objekteve administrative ne Komunen e Kamenicës kodi i projektit 55083,shuma prej 5,000.00 €.

**Në Projektin ekzistues:**

- Blerja e veturave per nevoja te administrates komunale ,kodi i projektit 55069,shuma prej 25,000.00 €.

5. **Rialokimet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 22 nënprogrami Planifikimi Urban dhe Inspekcioni /66450/ shuma prej 12,616.53 €.**

**<u>Nga Projekti:</u>**

- Asfaltimi i rrugeve lokale ne Petrit, kodi i projektit54880, shuma prej 12,616.53 €.

**Në Projektin ekzistues**

- Asfaltimi i rrugeve ne Hodonoc, kodi i projektit 54877, shuma prej 12,616.53 €.

6. **Transferet e mjeteve nga kategoria e shpenzime kapitale nga fondi burimor 10 shuma prej 70,000.00 €.**

- **Nga Projektet:**

1. Projekti " Ndertimi I pritoreve te autobusve ne Hogosht,Shpashnice e Poshtme,Hodonoc,Topanic,Koretin,Kopernice dhe Petrit ,nenprogrami Infrastruktura Publike (18189),kodi I projektit 55072,shuma 30,000.00
2. Ndertimi I tezgave per tregje mobile ne qytet dhe Rogane H.K,nenprogrami Planifikimi I zhvillimit ekonomik /48029/,kodi I projektit 54787,shuma prej 10,000.00
3. Ndertimi I kanalizimit fekal ne Kamenice dhe fshatra Shipashnice,Karaqeve,Busavate,Kopernice,Koretin,Topanice,nenprogrami Infrastruktura Publike /18189/,kodi I projektit 53338,shuam prej 10,000.00€
4. Ndertimi I deponive per mbeturina te ngurta ne Berivojce,Topanice,Kolloleq e Novoselle, nenprogrami Infrastruktura Publike /18189/,kodi I projektit 54744,shuam prej 10,000.00€

**Në Projektin ekzistues**

1.Projekti ekzistues "Ndertimi I tereneve sportive ne kuader te institucioneve arsimore ne Rogane ,Karaqeve,Kamenice,Petrit,Topanice," në nën programin Arsimi Fillor (93840) kodi i projektit ekzistues 54922 në shumë prej **15,000.00€**
2.Projekt ekzistues "Ndertimi I parqeve ne Kamenice,parku ne qendren e vjeter qytetit,parku te amfiteatri i bulevardit,parku mbrapa shtepise se kultures ne qytet dhe Petrit nen programi Planifikimi Urban dhe Inspekcioni 66450 ,kodi I projektit 52855,shuma prej 5,000.00
3.Projekti ekzistues Ndertimi I urave metalike/beton per kembesor ne Koretin,Hajnoc,Berivojc,Karaqeve,nenprogrami Planifikimi Urban dhe Inspekcioni /66450/,kodi I projektit 55078,shuma prej 40,000.00€

7. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Bugjetit.

8. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

**Vendimi u dërgohet:**

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Kuvendit;
- Drejtorisë për Financa dhe Buxhet;
- MAPL-së;
- Arkivit.

**Liridon Kastrati**

**Kryesues i Kuvendit të Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. Br. 01 Nr. Br. 2659
Nr. i faq. Br. str. 2 Data Datum: 03/02 2025
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Datë: 30.01.2025**

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 38 të Statutit Sh.02.nr.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2025, miraton këtë:

# VENDIM

## Për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin 2025

### Neni 1

Me këtë Vendim, Kuvendi Komunal i Kamenicës MIRATON vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Kamenicës për vitin 2025.

Miratojmë këtë Komision:

1. Liridon Kastrati, Kryesuesi i Kuvendit Komunal

2. Lirim Kryeziu, Këshilltar/e komunal nga të VV-së

4. Labinot Skoverqan, Këshilltar/e komunal nga - të AAK-së

5. Sejdi Kureshi, Këshilltar/e komunal nga LDK-së

6. Rabit Dërmaku, Këshilltar/e komunal nga PDK-së

7.Labinot Maliqi, Këshilltar/e komunal nga AKR-së

8.Jadranka Nikolic, Këshilltar/e komunal SL-së

9. Violeta Krasniqi, Zyrtare e Kuvendit

10. Sherafedin Vranja, Përfaqësues/e nga shoqëria civile

### Neni 2

Grupi punues, konform nenit 1 të këtij vendimi, në konsultim me kryetarin e Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuara në kuvend dhe shoqërinë civile, harton draftin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin kalendarik 2025 dhe të njëjtin e paraqet para kuvendit të komunës për miratim.

### Neni 3

Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbajë objektivat dhe qëllimet e kuvendit, aktivitetet e planifikuara të kuvendit dhe komiteteve obligative dhe funksionale të kuvendit, afatet e përmbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara, si dhe koston financiare për implementimin e Planit të punës.

**Neni 4**

Plani i punës së kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Kamenicës.

**Neni 6**

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Anëtarëve të grupit punues; dhe
- QSHQ - Arkivit.

**Liridon Kastrati**

______________________

**KRYESUESI I KUVENDIT**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 2662
faq. Br. str. 1 Data: Datum: 03/02 2025
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 30.01.2025**

Bazuar në nenin 11,12, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, neni 14.1, neni 17 pika c), dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 (E drejta e komunës për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga institucionet qendrore) të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës se Paluajtshme të Komunës, nenit 34 dhe 35 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h), neni 38 të Statutit Sh.02.nr.20203 i dates 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025 miraton këtë:

**VENDIM**
**PËR SHPALLJEN NË INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK**

1. Vendim për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të objektit me numër O-71107041-01533-1-47-0 me sipërfaqe 322 $m^2$ aset i cili është nën menaxhimin e AKP, objekt i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-71107041-01981-0 në Zonën Kadastrale Kamenicë.

2. Shpallja me Interes të Përgjithshëm Publik ka për qëllim themelimin e Qendrës së Artizanateve.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, për zbatimin e tij do të kujdesen Kryetari i Komunes, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës të vazhdojnë me procedurat për bartjen e këtyre pronave në emër të Komunës.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet:*** *Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit,Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë, MAPL-së dhe QSHQ- arkivi.*

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**Liridon Kastrati**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 2664
Nr. i faq. Br. str. 1 Data Datum: 03/02 2025
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Datë: 30.01.2025**

Bazuar në nenin 11,12, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 shkronja d), neni 14.1, neni 17 pika c), dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 (E drejta e komunës për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga institucionet qendrore) të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës se Paluajtshme të Komunës, nenit 34 dhe 35 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h), neni 38 të Statutit Sh.02.nr.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2025, miraton këtë:

**V E N D I M**
**PËR SHPALLJEN NË INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK**

1. Vendim për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të objektit me numër O-71107041-1530-0-46-0 me sipërfaqe 198 $m^2$ · aset i cili është nën menaxhimin e AKP, objekt i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-71107041-01984-0 në Zonën Kadastrale Kamenicë.

2. Shpallja me Interes të Përgjithshëm Publik ka për qëllim themelimin e Galerisë së Arteve.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, për zbatimin e tij do të kujdesen Kryetari i Komunes, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës të vazhdojnë me procedurat për bartjen e këtyre pronave në emër të Komunës.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Zyrës së Përkthimeve, MAPL-së dhe QSHQ- arkivi.*

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**Liridon Kastrati**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 2666
Nr. i faq. Br. str. 1 Data Datum: 03/02
KAMENICË/A 2025

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 30.01.2025**

Bazuar në nenin 11,12, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, neni 14.1, neni 17 pika c), dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 (E drejta e komunës për bartjen në pronësi të pronës së paluajtshme të administruar nga institucionet qendrore) të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës se Paluajtshme të Komunës, nenit 34 dhe 35 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h), neni 38 të Statutit Sh.02.nr.20203 i dates 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025 miraton këtë:

## VENDIM
## PËR SHPALLJEN NË INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK

1. Vendim për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të objektit me numër O-71107041-1983-9-25-0 me sipërfaqe 129 $m^2$ aset i cili është nën menaxhimin e AKP, objekt i cili gjendet në ngastrën kadastrale P-71107041-01605-9 në Zonën Kadastrale Kamenicë.

2. Shpallja me Interes të Përgjithshëm Publik ka për qëllim themelimin Muzeut të qytetit.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, për zbatimin e tij do të kujdesen Kryetari i Komunes, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës të vazhdojnë me procedurat për bartjen e këtyre pronave në emër të Komunës.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet:*** *Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit,Zyrës së Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe QSHQ- arkivi.*

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**Liridon Kastrati**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**
**KOMUNA E KAMENICËS**
**OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 2667
Nr. i faq. Br. str. 2 Data Datum: 03/02 2025
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më:30.01.2025**

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d) dhe 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenin 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 5 paragrafi 5.1 shkronja h) dhe 38 të Statutit 01.Nr.20203 datë 21.06.2023. Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025 miraton këtë:

# V E N D I M

**(Për publikim të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025)**

1. **MIRATOHET** Vendimi për publikim të listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025 nga Komuna e Kamenicës.

2. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim ka për qëllim zhvillimin ekonomik dhe interesin publik të Komunës, do të jetë në përputhje të plotë me Ligjin Nr (06/L-092) për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale.

3. Propozim vendimit i bashkangjitet Lista Sh.01.Nr.38357 e datës 16.12.2024 e përgjithshme dhe Sh.01.Nr.38355 e datës 16.12.2024 e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës për publikim të cilat planifikohen të jepën në shfrytëzim për vitin 2025.

4. Për zbatimin e këtij vendimit kujdeset Kryetari i Komunës së Kamenicës së bashku me Drejtoritë përkatëse.

5. Vendimi shpallet 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Vetëqeverisjen Lokale, dhe hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dorëzohet:***
- Zyrës së Kryetarit,
- Zyrës së Kuvendit Komunal,
- Zyrës së përkthimeve
- MAPL-së
- Q.SH.Q
- Arkivit

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**Liridon Kastrati**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 2668
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 03/02 2025
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 30.01.2025**

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d), nenit 17 shkronja h) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 102/2020 emërtimi dhe riemërtimi i institucioneve publike edukative-arsimore dhe aftësuese parauniversitare, Vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Nr. 2-3726 të datës 28.08.2019, nenit 38 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025 miraton këtë:

# V E N D I M

## Për ndërrimin e akronimit nga SHMLP "Andrea Durrsaku" në IAAP "Andrea Durrsaku" në Kamenicë

1. Me këtë vendim bëhet ndërrimi i akronimit nga Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale (Sh.M.L.P) "Andra Durrsaku" në Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (I.A.A.P) "Andrea Durrsaku" në Kamenicë.

2. Ky ndërrimi i akronimit sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASH) Nr. 102/2020 emërtimi dhe riemërtimi i institucioneve publike edukative- arsimore dhe aftësuese parauniversitare si dhe vendimit Nr. 2-3726 të datës 28.08.2019 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

3. Autorizohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria Komunale për Arsim në Komunën e Kamenicës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria Komunale për Arsim.

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- *Zyrës së Kryetarit;*
- *Shërbimit të Kuvendit;*
- *Zyrës së Përkthimeve*
- *Drejtorisë Komunale të Arsimit;*
- *QSHQ*
- *MAPL-së*
- *Arkivit.*

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**Liridon Kastrati**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐAN
Nr. 01 Nr. Br. 2669
Nr. i faq. Br. str. 2 Data Datum: 03/02 2025
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 30.01.2025**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja d), neni 7 paragrafi 7.3 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenit 3 dhe neni 38 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2025 miraton këtë:

# VENDIM

## PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INICIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIMIN E STEMËS SË KOMUNËS SË KAMENICËS

1. Miratohet formimi i Komisionit për inicimin e procedurave për ndryshimin e stemës së Komunës së Kamenicës.

2. Mbështetur në pikën 1 të këti vendimi Komisioni do të jetë në këtë përbërje:

   **2.1.** Liridon Kastrati - Kryesues; Nga Kuvendi nga Kuvendi Komunal
   **2.2.** Donjeta Ismajli - anëtarë nga Kuvendi Komunal- LVV
   **2.3.** Shpresa Sermaxhaj - anëtarë nga Kuvendi Komunal LDK
   **2.4.** Labinot Skoverqani - anëtar nga Kuvendi Komunal AAK
   **2.5.** Florim Kryeziu - anëtarë nga Kuvendi Komunal PDK
   **2.6.** Edon Dërmaku - anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës.
   **2.7.** Shafredin Vranja - anëtarë nga OJQ

3. Për zbatimin e këti vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Komisionit sipas pikes 2 të këtij vendimi që ti zhvilloj procedurat e parapara ligjore për ndryshimin e Stemës së Komunës së Kamenicës, dhe pas realizimit të procedurave ti dërgoj për shqyrtim dhe Miratim në Kuvendin e Komunës.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Kamenicës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes ne ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi i`u dërgohet:***

- Zyrës së Kryetarit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Antarëve të grupit punues;
- MAPL-së; dhe
- QSHQ - Arkivit.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

___________________________

**Liridon Kastrati**